



*The outpost of the time - Posta e kohës*

---

**SULTAN CATTO**

---

**THE OUTPOST OF  
TIME  
POSTA E KOHËS**

**Poezi - Poetry**

Sultan Catto.

---



## Biblioteka



Edition IWA BOGDANI

[www.iwabogdani.org](http://www.iwabogdani.org)

[iwabogdani@gmail.com](mailto:iwabogdani@gmail.com)

IWA Bogdani, Brussels – Prishtinë

0032494464251

Autor: **Sultan Catto**

Redaktor:

**Xhemil Bytyçi**

**Përktheu nga Anglishtja: Jeton Kelmendi**

Dizajni i brendshëm: Bogdani Design

Ballina: IWA Bogdani

Ballona: IWA Bogdani

Copyright © - **Sultan Catto and IWA Bogdani**

**ISBN 978-9951-394-71-0**



The outpost of the time - *Posta e kohës*

---

**SULTAN CATTO**

**THE OUTPOST OF  
TIME  
POSTA E KOHËS**

- Poezi - Poetry -



**Bruxelles – Pristina  
2026.**

**Sultan Catto.**

---





## POSTA E KOHËS – NJË UNIVERS POETIK MES KOZMOSIT DHE SHPIRTIT

Nga Prof. Jeton Kelmendi

Libri *The Outpost of Time / Posta e Kohës* i Sultan Catto-s është një vëllim poetik që nuk mund të lexohet vetëm si një përmbledhje tekstesh lirike, por si një arkitekturë e tërë mendimi, një laborator metafizik ku koha, kujtesa, dashuria, kozmosi dhe vetëdija përplasen, shkrihen dhe rigjenerohen nëpërmjet figuracionit të fuqishëm simbolik. Ky libër është një udhëtim midis dimensioneve: nga mikrokozmosi i shpirtit individual deri te makrokozmosi i galaktikave, nga kujtimi personal deri te përjetësia abstrakte.

### **Koncepti tematik: Koha si hapësirë shpirtërore**

Tema qendrore e librit është koha, jo si kronologji lineare, por si një entitet i lëvizshëm, i përthyeshëm, i ndërthurur me hapësirën dhe me vetëdijen. Në shumë poezi, si “To Pass Through Time”, “At the Outpost”, “Enjambment”, koha shfaqet si një strukturë elastike që mund të rrëshqasë, të mbytet, të shpërbëhet apo të rilindë. Ajo nuk është thjesht një rrjedhë, por një terren ku shpirti kërkon kuptim. Poezia nuk e trajton kohën si armike, ajo e trajton si një stacion tranzitor, si një “postë” ku njeriu ndalet për të reflektuar mbi të shkuarën, për të imagjinuar të ardhmen dhe për të përjetuar intensitetin e së tashmes. Kujtesa shpesh paraqitet si një pjerrësi: herë pozitive që të ngre drejt yjeve, herë negative që të



rrëshqet në oqeanet e ëndrrave. Kjo metaforë gjeometrike e kujtesës tregon se poeti e ndërton përvojën ekzistenciale mbi një fushë dinamike forcash. Një tjetër temë madhore është bashkimi kozmik dhe dashuria e përfytyruar si bashkim yjesh, si vrimë e zezë, si energji termodinamike. Në poezinë “Bonding”, dy shpirtra përfytyrohen si dy yje gjigantë që rrotullohen rreth njëri-tjetrit dhe shndërrohen në një njësi kozmike. Dashuria këtu nuk është thjesht ndjenjë, por ajo është fenomen astronomik.

### **Stili i vargut: Liri strukturore dhe muzikalitet i brendshëm**

Vargu i Sultan Catto-s është i lirë, pa metër tradicional, por me një ritëm të brendshëm që buron nga përsëritjet, nga strukturat sintaksore të zgjeruara dhe nga ndërthurja e imazheve. Ai përdor shpesh enjambement-in, (Kapërcimin) duke lejuar mendimin të rrjedhë përtej kufijve formalë të vargut. Kjo teknikë i jep poezisë një ndjesi rrëshqitjeje, një lëvizje të vazhdueshme që pasqyron vetë konceptin e kohës si rrjedhë e pambarimtë. Figura letrare është e ngarkuar me metafora kozmike, fizike, muzikore. Termat si “space-time fabrics”, “black hole”, “thermodynamic disorder”, “constellations”, “cumulonimbus” nuk janë thjesht elemente dekorative; ato krijojnë një gjuhë hibride ku shkencë dhe mistika bashkëjetojnë. Ky bashkim i diskursit shkencor me atë poetik i jep tekstit një thellësi moderne, një rezonancë bashkëkohore. Muzikaliteti i vargut shpesh mbështetet në përsëritje konceptuale (“If only... If...”) që krijojnë efekt



meditativ, pothuajse mantrik. Poeti shpesh i kthehet heshtjes si element strukturor, ndërsa muzika që shpik heshtjen, fjalët që flenë mbi sexhade të hollë, zëri që zhduket për të lindur sërish në natë. Heshtja bëhet një formë e lartë komunikimi.

### **Qasja poetike: Mistike, filozofike dhe ndërdisiplinore**

Qasja poetike e librit është thellësisht mistike, por jo në kuptimin dogmatik fetar. Kjo qasje është një mistikë e përvojës së brendshme. Figura e dervishit, e murgu sufi, e shamanit, e poetit që endet në kozmos janë metafora të kërkimit shpirtëror. Poeti nuk kërkon të japë përgjigje, thjeshtë, ai kërkon të udhëtojë në pyetje. Në shumë poezi, subjekti lirik është në kërkim të një “syri të tretë”, të një shikimi të brendshëm që e çon përtej realitetit të dukshëm. Ai dëshiron të “kalojë nëpër kohë”, të migrojë mes shtresave të hapësirë-kohës, të ndërtojë fyell nga kallamishtet e kujtesës. Kjo qasje e vendos librin në një traditë të poezisë filozofike ku përvoja individuale shndërrohet në reflektim universal.

Një dimension i rëndësishëm është ndërdisiplinariteti. Poezia përfshin referenca muzikore (Coltrane, saksofoni, progresionet harmonike), fizike (vrime e zezë, rezonanca), matematikore (referenca për implikimet e matematikës), mitologjike (Andromeda, sferat qiellore). Kjo e bën tekstin një hapësirë dialogu mes disiplinave – një poezi që nuk mbyllet në vetvete, por që hap dritare drejt dijes.



## **Mendimi i thellë: Ekzistenca midis dritës dhe hijes**

Në thelb, libri trajton dilemën ekzistenciale të njeriut: si të jetojë midis hijes dhe dritës. Në poezinë “Under the Exile of Shadows”, subjekti lirik pranon se njeriu duhet gjithmonë të ketë hije dhe dritë. Ky dualitet është themelor: asgjë nuk merr formë pa kontrastin e saj. Shpesh, subjekti përshkruhet si një busull, si një trumpetë e vjetër, si një flamur në mes të stuhisë. Ai është i brishtë, por njëkohësisht i vetëdijshëm për dimensionin e tij kozmik. Ai është “kukullari dhe kukulla” – krijuesi dhe krijesa, autori dhe personazhi i vetes. Ky vetëdijësim për rolin e dyfishtë e bën librin një reflektim mbi aktin krijues.

Në poezinë “Passing the Torch”, pasqyra bëhet simbol i introspeksionit. Ajo nuk është vetëm objekt reflektimi, por instrument transformimi. Poeti e ofron pasqyrën lexuesit – një gjest etik, një thirrje për vetë-njohje. Kjo e kthen librin në një dialog midis autorit dhe lexuesit.

## **Dimensioni emocional: Nostalgjia dhe dashuria**

Edhe pse libri është i ngarkuar me metafora kozmike, ai nuk e humb dimensionin emocional. Nostalgjia, humbja, kujtimi i të dashurës, aroma që mbetet mbi divan janë elemente konkrete që e rrënjosin poezinë në përvojën njerëzore. Kozmosi nuk është arratisje nga jeta; është zgjerim i saj. Dashuria shpesh shfaqet si energji transformuese. Ajo e çon subjektin nga gjendja e shpërbërjes në një bashkim të ri, nga



fragmentimi në unitet. Edhe kur përjetimi është i dhimbshëm, ai mbetet krijues.

Si njeri që krejt jetën e ka të lidhur me poezinë dhe poetikën dhe para së gjithash si lexues i përkushtuar me bindje mund të konstatoj se libri *Posta e Kohës e autorit Sultan Catto* është një vëllim që e tejkalon kufirin e një libri poetik tradicional. Ai është një traktat poetik mbi kohën, ekzistencën dhe kërkimin e kuptimit. Me një gjuhë të pasur metaforike, me një stil vargu të lirë e meditativ, me një qasje mistike e ndërdisiplinore, libri krijon një univers ku njeriu përballet me pafundësinë, por pa humbur intimitetin e shpirtit. Në këtë vepër, poeti nuk është vetëm rrëfimtari, ai është udhëtar kozmik, shaman i fjalës, rrobaqepës i hijes dhe dirigjent i errësirës. Koha nuk është thjesht kalim, por është një stacion ku shpirti ndalet për të reflektuar, për t'u përthyer, për t'u rilindur.

Kjo e bën librin një vepër me thellësi filozofike dhe rezonancë universale, një poezi që kërkon jo vetëm të lexohet, por të meditohet.

*Prishtinë, me 26 shkurt 2026*



---

## THE OUTPOST OF TIME – A POETIC UNIVERSE BETWEEN COSMOS AND SOUL

By Jeton Kelmendi

The book *The Outpost of Time / Posta e Kohës* by Sultan Catto is a poetic volume that cannot be read merely as a collection of lyrical texts, but rather as a complete architecture of thought, a metaphysical laboratory where time, memory, love, the cosmos, and consciousness collide, dissolve, and regenerate through powerful symbolic imagery. This book is a journey between dimensions: from the microcosm of the individual soul to the macrocosm of galaxies, from personal memory to abstract eternity.

### **Thematic Concept: Time as Spiritual Space**

The central theme of the book is time—not as linear chronology, but as a fluid, pliable entity intertwined with space and consciousness. In many poems, such as “To Pass Through Time,” “At the Outpost,” and “Enjambment,” time appears as an elastic structure that can slip, submerge, disintegrate, or be reborn. It is not merely a flow, but a terrain where the soul seeks meaning. Poetry does not treat time as an enemy; rather, it approaches it as a transitional station, an “outpost” where one pauses to reflect on the past, imagine the future, and experience the intensity of the present.



Memory often appears as an incline—at times positive, lifting one toward the stars; at other times negative, sliding into the oceans of dreams. This geometric metaphor of memory reveals that the poet constructs existential experience upon a dynamic field of forces. Another major theme is cosmic union and love envisioned as the merging of stars, as a black hole, as thermodynamic energy. In the poem “Bonding,” two souls are imagined as giant stars orbiting one another, eventually transforming into a single cosmic unit. Love here is not merely emotion—it is an astronomical phenomenon.

### **The Style of the Verse: Structural Freedom and Inner Musicality**

Sultan Catto’s verse is free, without traditional meter, yet sustained by an internal rhythm born of repetition, expanded syntactic structures, and interwoven imagery. He frequently employs enjambment, allowing thought to flow beyond the formal boundaries of the line. This technique gives the poetry a sense of glide, a continuous movement reflecting the very concept of time as an endless current. The figurative language is rich with cosmic, physical, and musical metaphors. Terms such as “space-time fabrics,” “black hole,” “thermodynamic disorder,” “constellations,” and “cumulonimbus” are not merely decorative; they create a hybrid language in which science and mysticism coexist. This union of scientific and poetic discourse grants the text a modern depth and contemporary resonance.



The musicality of the verse often relies on conceptual repetition (“If only... If...”) that creates a meditative, almost mantra-like effect. Silence becomes a structural element: music that invents silence, words that sleep upon delicate prayer rugs, a voice that disappears only to be reborn in the night. Silence becomes a higher form of communication.

### **Poetic Approach: Mystical, Philosophical, and Interdisciplinary**

The book’s poetic approach is profoundly mystical, though not in a dogmatic religious sense. It is a mysticism of inner experience. The figures of the dervish, the Sufi monk, the shaman, the poet wandering through the cosmos—all serve as metaphors for spiritual quest. The poet does not seek to provide answers; he seeks to journey through questions. In many poems, the lyrical subject searches for a “third eye,” an inner vision that transcends visible reality. He longs to “pass through time,” to migrate between layers of space-time, to build a flute from the reeds of memory. This approach situates the book within the tradition of philosophical poetry, where individual experience transforms into universal reflection.

An important dimension is interdisciplinarity. The poetry includes musical references (Coltrane, the saxophone, harmonic progressions), physical concepts (black holes, resonance), mathematical implications, and mythological allusions (Andromeda, celestial spheres). The text thus becomes a space of dialogue



between disciplines—a poetry that does not enclose itself, but opens windows toward knowledge.

### **Profound Thought: Existence Between Light and Shadow**

At its core, the book addresses the existential dilemma of human beings: how to live between shadow and light. In the poem “Under the Exile of Shadows,” the lyrical subject acknowledges that one must always possess both shadow and light. This duality is fundamental; nothing takes shape without contrast.

The subject is often described as a compass, an old trumpet, a flag amid a storm. He is fragile, yet aware of his cosmic dimension. He is both “puppeteer and puppet”—creator and creation, author and character of himself. This awareness of a dual role renders the book a reflection on the creative act itself.

In “Passing the Torch,” the mirror becomes a symbol of introspection. It is not merely an object of reflection, but an instrument of transformation. The poet offers the mirror to the reader—an ethical gesture, a call to self-knowledge. The book thus becomes a dialogue between author and reader.

### **The Emotional Dimension: Nostalgia and Love**

Although the book is laden with cosmic metaphors, it does not lose its emotional depth. Nostalgia, loss, the memory of a beloved, the lingering



scent upon a sofa—these concrete elements root the poetry in human experience. The cosmos is not an escape from life; it is its expansion. Love frequently appears as transformative energy. It moves the subject from disintegration to new union, from fragmentation to unity. Even when the experience is painful, it remains creative.

As someone whose entire life has been bound to poetry and poetics, and above all as a devoted reader, I can affirm with conviction that *Posta e Kohës* by Sultan Catto transcends the boundaries of a traditional poetic book. It is a poetic treatise on time, existence, and the search for meaning. With its rich metaphorical language, free and meditative verse, mystical and interdisciplinary approach, the book creates a universe in which humanity confronts infinity without losing the intimacy of the soul. In this work, the poet is not merely a narrator; he is a cosmic traveler, a shaman of the word, a tailor of shadows, and a conductor of darkness. Time is not simply passage—it is a station where the soul pauses to reflect, to bend, to be reborn.

This makes the book a work of philosophical depth and universal resonance—a poetry that seeks not only to be read, but to be contemplated.

*Prishtina, February 26, 2026*



## IN SEARCH OF WISDOM

Full of verve and emotions, the old whirler  
never wanted to kneel on the ground,  
vividly preferred looking up to the sky,  
for sites with happier stars and suns,  
desired happiness to spin with his soul,  
craved to become a dancer, to dream  
in beautiful verses, smile in italics,  
live in pronouns in the fiction of his spirit.

Awaited liberty to be able to hike  
through the miles of veiled shadows  
entrenched in his unbounded soul,  
to seek out and follow the wind,  
twirl into a boundless mystical sage,  
visit all continents, experience all  
the sensations of the chaotic universe.

Yet, he learned everything without traveling,  
saw without looking, worked without doing,  
became a new dawn waiting to rise.  
Then grew into a slowly rising moon  
lighting up poetry's forbidden dark alleys.



## NË KËRKIM TË URTËSISË

Plot gjallëri e emocione, rrotulluesi i vjetër  
kurrë nuk deshi të gjunjëzohej mbi tokë,  
me gjallëri shikonte vetëm kah qielli,  
drejt vendeve me yje e diell më të lumtur,  
dëshironte lumturinë ta rrotullonte me shpirtin e tij,  
donte të bëhej valltar, të ëndërronte  
në vargje të bukura, të buzëqeshte në kursive,  
të jetonte nëpër përemra, në trillimin e shpirtit të tij.

Pritej liria që ai të mund të endej  
nëpër milje hijesh të mbuluara  
që nguliteshin në shpirtin e tij të pakufishëm,  
të kërkonte e ndiqte erën,  
të shndërrohej në një urtak mistik pa kufij,  
të vizitonte të gjithë kontinentet, të përjetonte  
gjithë ndjesitë e universit kaotik.

Megjithatë, ai i mësoi të gjitha pa udhëtuar,  
pa parë, pa bërë asgjë,  
u bë një agim i ri që priste të lindte.  
Pastaj u kthye në një hënë që ngrihej ngadalë  
duke ndriçuar rrugicat e ndaluara të errta të poezisë.



## PERCHING AFTER THE TIME-SIEGE

Drops of pronouns sliding over my inner canopy  
wet the lines gathered in my soul's turbulent ocean,  
where gusting winds are humming an unfamiliar song.

Old willow too, bending in my psyche's garden  
is busy taking on the storm's violent shape,  
its yellowed leaves blowing everywhere,  
fleeting in unpredictable tracks.

I am becoming like Thoreau, retreating to the  
bottomless Walden Pond, my heartbeats shuttling  
between day and night, wet words carrying my emotions  
in those intervals with their bells tolling through  
remaining mists, their shadows entirely lost,  
spilling themselves over my space-time fabrics.

Momentarily, toward the twilight margins of newly  
concocted poems will rebel, overflow their banks,  
flood my texts, where a new verse will arise in the midst  
of the crossed-out landscape as the hurricane subsides.



## PUSHIM PAS RRETHIMIT TË KOHËS

Pikat e përemrave që rrëshqasin mbi kupolën time të brendshme lagin rreshtat e mbledhur në oqeanin e trazuar të shpirtit tim, ku erërat e forta fishkëllenin një këngë të panjohur.

Edhe shelgu i vjetër, i përkulur në kopshtin e psikes sime, është i zënë duke marrë formën e dhunshme të stuhisë, gjethet e tij të verdhura shpërndahen kudo, duke humbur në gjurmë të paparashikueshme.

Po bëhem si Thoreau, duke u tërhequr në Pellgun e pafund të Waldenit, rrahjet e zembrës sime lundrojnë mes ditës dhe natës, fjalët e lagura bartin emocionet e mia në ato intervale, me kabanat e tyre që bien nëpër mjegullat e mbetura, hijet e tyre krejt të humbura, duke u derdhur mbi fijet e hapësirë-kohës sime.

Së shpejti, drejt skajeve të muzgëta të poezive të sapokrijuara, ato do të ngrihen, do të dalin nga brigjet, do të përmytin tekstet e mia, ku një varg i ri do të lindë në zemër të peizazhit të ndërkryqëzuar, sapo të jetë shuar uragani.



## ODE TO WHITMAN

Snowman.

Lived like a man,  
melted like a poet.

Left behind two coals  
squatting on green meadows  
scrutinizing the stars.

Poet.  
Soul feeder.  
Black pearl.

Error of Snow on Blades of Grass.



---

## ODE PËR NJERIUN E BARDHË

Njeri bore.

Jetoi si njeri,  
u shkrinë si poet.

Pas la dy prushë  
të ulur mbi livadhe të gjelbra,  
duke vëzhguar yjet.

Poet.  
Ushqyes i shpirtit.  
Perlë e zezë.

Gabim bore mbi tehë bari.



## DANCER

Walking to music  
tighter than a piano string,  
she performs a sacred dance.  
Cymbals at fingertips,  
heart at the origin of rhythm,  
eyes not attentive  
to the blues of the season,  
undresses the night,  
within a glass of ruby wine.

Distilled like a rare essence  
from abstract truth,  
separating herself from  
far-off lands of literature,  
her motions resemble the sea.

Like the sea  
she is the distant spirit,  
The memory of the city,  
master of the bush and its mystery,  
a bird on a wire.

The weightiness of her eyelids  
savors time and salt.

She drops her wings  
to the waters below,  
fashioning waves,  
melodic lines  
weaving in and out of  
harmonic progressions.

**Sultan Catto.**

---



A black shirt and a little scarf,  
a seductive smile  
hidden behind a mask,  
she leaves, as she must  
with the ebbing tide  
dancing away the night  
on a tightrope,  
sailfish  
blowing bubbles.



## BALERINA

Duke ecur drejt muzikës,  
më e tendosur se një tel pianoje,  
ajo kryen një vallëzim të shenjtë.

Cimballa në majë të gishtave,  
zemra në burimin e ritmit,  
sytë jo të vëmendshëm  
ndaj bluve të stinës,  
zhvesh natën  
brenda një gote vere rubini.

E distiluar si një esencë e rrallë  
nga e vërteta abstrakte,  
duke u shkëputur nga  
tokat e largëta të letërsisë,  
lëvizjet e saj i ngjajnë detit.

Si deti,  
ajo është shpirti i largët,  
kujtesa e qytetit,  
zotëruese e shkures dhe misterit të saj,  
një zog mbi tel.

Pesha e qepallave të saj  
shijon kohën dhe kripën.  
Ajo i lëshon krahët  
ujërave poshtë,  
duke formësuar valë,  
vija melodike  
që hyjnë e dalin  
në progresione harmonike.

## Sultan Catto.

---



Një këmishë e zezë dhe një shall i vogël,  
një buzëqeshje joshëse  
e fshehur pas një maske,  
ajo largohet, siç duhet,  
me zbatcën që tërhiqet,  
duke vallëzuar larg natën  
mbi një litar të tendosur,  
peshk-shpatë  
që fryn flluska.



## IF ONLY

If only I could place my lips next to your cheeks,  
pretend to whisper a poem from the heart,  
will you stir up the whirlwinds of furious fire  
lift your hands to reach the stars?

If only I could convert my spirit full of warm feelings  
into a high-temperature superconducting state  
and enter your soul without any resistance,  
would I be able to remain there like an ancient fire king  
warming you from within, during your wintry months?

If only I...  
If only...  
If.

You see, with the coming of age I mastered  
the meaning of quiet,  
music inventing silence,  
rivers molding time,  
still in awe of the man I pretend to be,  
if only I could turn into a Sufi monk,  
wandering the cosmos,  
if only I could reach the point where my pencil breaks.

If only...  
If.



## SIKUR VETËM

Sikur vetëm t'i vendosja buzët pranë faqeve të tua,  
të bëja sikur pëshpëris një poezi nga zemra,  
a do t'i ngrije vorbullat e zjarrit të tërbuar,  
a do t'i ngrije duart për të prekur yjet?

Sikur vetëm ta shndërroja shpirtin tim plot ndjenja të  
ngrohta në një gjendje superpërcjellëse me temperaturë të  
lartë dhe të hyja në shpirtin tënd pa asnjë rezistencë,  
a do të mund të qëndroja atje si një mbret i lashtë i zjarrit,  
duke të ngrohur nga brenda gjatë muajve të tu dimërorë?

Sikur vetëm unë...

Sikur vetëm...

Sikur.

E sheh, me ardhjen e moshës mësova  
kuptimin e qetësisë,  
muzikën që shpik heshtjen,  
lumenjtë që gdhendin kohën,  
ende i mahnitur nga njeriu që bëj sikur jam,  
sikur vetëm të mund të shndërrohesh në një murg sufi,  
duke bredhur kozmosin,  
sikur vetëm të arrija në pikën ku lapsi im thyhet.

Sikur vetëm...

Sikur.



## BONDING

Two massive stars, we twirled around each other,  
full of hidden secrets in our souls,  
buried ourselves in creating passionate songs.

After folding into a newly formed black hole  
we went hiding from the rest of the universe as one.

In that immense union, we experienced a fresh life,  
newly crafted poems glowed in the heat of a single stone.

Our flowing rivers unite between indecisive walls  
hid unfamiliar universes striding by  
between freshly coined words and pronouns.  
Silence became our tutor,  
our single soul became satiated with new wines  
we experienced for the first time.

Under the wings of a pure thermodynamic disorder  
ripples we produced scattered into the cosmos,  
offered alien tastes to thirsty lips in melted hours  
to those circling galaxies outside us,  
to whirling dervishes in search of harmony.



## LIDHJE

Dy yje gjigantë, rrotulloheshim rreth njëri-tjetrit,  
plot sekrete të fshehta në shpirtrat tanë,  
u fundosëm në krijimin e këngëve të zjarra.

Pasi u palosëm në një vrimë të zeze të sapolindur,  
u fshehëm nga pjesa tjetër e universit si një i vetëm.

Në atë bashkim të pamasë, përjetuam një jetë të re,  
poezi të sapokrijuara ndriçonin  
në nxehtësinë e një guri të vetëm.

Lumenjtë tanë rrjedhës u bashkuan  
mes mureve të pavendosura,  
fshehën universë të panjohur që kalonin  
mes fjalëve dhe përemrave të saposhpikur.

Heshtja u bë mësuesja jonë,  
shpirti ynë i vetëm u ngop me verëra të reja  
që i shijuam për herë të parë.

Nën krahët e një çrregullimi termodinamik të pastër,  
valëzimet që prodhuam u shpërndanë në kozmos,  
u ofruan shije të huaja buzëve të etura  
në orë të shkrira,  
galaktikave që rrotulloheshin jashtë nesh,  
dervishëve rrotullues në kërkim të harmonisë.



## CHASING COLTRANE

Walking down the Bellagio Stairs,  
retrieving melodies of old sax moans  
perched upon the staircase of scales  
in semitones, fleeting through  
the layers of spacetime,  
hours weighing heavily upon his fingertips,  
a pencil leaving its faltering graphite trail  
upon staves over his soul's blank pages,  
a saxophonist rambling towards a lagoon at Lake Como,  
on the way to discover a hidden universe  
in a jazz song.



## DUKE NDJEKUR COLTRANE-IN

Duke zbritur shkallët e Bellagio-s,  
duke rimarrë meloditë e vjetra të rënkimeve të saksofonit,  
të vendosura mbi shkallaren e shkallëve muzikore,  
në gjysmëtonë, që rrëshqasin  
nëpër shtresat e hapësirë-kohës,

orët peshojnë rëndë mbi majat e gishtave të tij,  
një laps lë gjurmën e pasigurt të grafitit  
mbi pentagrame, mbi faqet e zbrazëta të shpirtit të tij,

një saksofonist që endet drejt një lagune në Liqenin e  
Komos,  
në udhë për të zbuluar një univers të fshehur  
brenda një kënge jazz.



## WAY IN

Repeating footsteps  
opens new pathways  
heading somewhere  
beyond memories,  
furnishing directions  
to the lost shadows-  
those anxious travelers  
charmed by the road  
who have forgotten  
their destinations.

A murmuring crowd  
outside the gate.  
They can only pass  
one by one.  
The poet is the turnstile.



## RRUGË HYRJEJE

Hapa që përsëriten  
hapin shtigje të reja,  
drejtohen diku  
përtej kujtimeve,  
duke pajisur me drejtime  
hijet e humbura  
ata udhëtarë të anktshëm  
të magjepsur nga rruga  
që kanë harruar  
destinacionet e tyre.

Një turmë murmuritëse  
jashtë portës.  
Mund të kalojnë  
vetëm një nga një.  
Poeti është turniketi.



## PUPPETEER

Reconciled to my blue destination,  
on a drunken boat,  
I am draining the blue  
from the bluest sky.  
My galloping thoughts,  
in a race with rushing waves,  
sail toward the shores.

I want to speak.

Waiting for calm,  
my voice disappears,  
my strength fades away.

When the night arrives,  
drinking its darkness  
I become visible again.

How calm  
the heavens become at night.

Sky heals its wounds  
in a pond of my soul,  
stars reserve their seats  
at this night's theater.

My fictional life  
dressed in white tissue,  
hunts sorrows,  
unending dreams  
on a stage  
of a shadow theatre.

I am the puppeteer  
and the puppet.



## KUKULLAR

I pajtuar me destinacionin tim blu,  
mbi një varkë të dehur,  
po e kulloj blunë  
nga qielli më blu.  
Mendimet e mia galopojnë,  
në garë me dallgët që vërsulen,  
lundrojnë drejt brigjeve.

Dua të flas.

Në pritje të qetësisë,  
zëri im zhduket,  
forca ime venitet.

Kur nata mbërrin,  
duke pirë errësirën e saj,  
bëhem sërish i dukshëm.

Sa i qetë  
bëhet qielli natën.

Qielli shëron plagët e tij  
në pellgun e shpirtit tim,  
yjet rezervojnë vendet  
në teatrin e kësaj nate.

Jeta ime fiktive,  
e veshur me pëlhurë të bardhë,  
gjuan dhimbje,  
ëndrra të pafundme  
mbi një skenë  
të teatrit të hijes.  
Unë jam kukullari  
dhe kukulla.



## SHIFTING CONSTELLATIONS

Inside a turbulent ocean  
holding onto a piece of lumber,  
blue waters, and I grew into  
one swaying being-  
the rhythm of our pulse  
replicated each other.

Veering at the corner of centuries,  
I began weaving  
thoughts' tapestry,

Gathered the art of trapping  
swerving planets between  
space-time sheets,

Acquired how to migrate time  
between entangled layers.

And up above in space,  
new constellations appeared:  
'Chained Woman' Andromeda  
was finally free of handcuffs,  
and the music of the spheres  
began rushing into new ages.



## YJËSI NË LËVIZJE

Brenda një oqeani të trazuar,  
duke u kapur pas një cope druri,  
ujëra blu – dhe u rrita në  
një qenie që lëkundej,  
ritmi i pulsit tonë  
pasqyronte njëri-tjetrin.

Në kthesën e shekujve,  
nisa të end  
tapicerinë e mendimeve,

mblodha artin e kapjes  
së planetëve që shmangen  
mes fletëve të hapësirë-kohës,

mësova si të migroj kohën  
mes shtresave të ndërthurura.

Dhe lart, në hapësirë,  
u shfaqën yjësi të reja:  
Andromeda, “Gruaja e lidhur”,  
më në fund u çlirua nga prangat,  
dhe muzika e sferave  
nisi të vërshojë drejt epokave të reja.



## ENJABMENT

Trying to take a leap toward the past,  
the dust in my eyes  
like the dust on the roads of my childhood village  
stops my efforts to pass through life's mirrors,  
clocks too don't want to allow me to travel through.

Like Rilke, I am learning how the heaviness of life  
is heavier than even the weight of things and thoughts.  
Pressure of reflected light in my eyes  
combined with the resistance of mirrors, too,  
stops my efforts to do time travel.

Even placing cotton in sentimental ears  
are no help. I must close my eyes,  
go back to the reedbed to let cane sugar  
rise in me, like Rumi once did.

Why is it that the past makes me anxious?  
It is a long empty vessel with one end closed,  
one must blow into it till you hit a resonance  
then the pressure of each moment will come through.

It is time to pull the cotton out and close my eyes,  
cut and dry the stalks, build a reed flute, empty out  
whatever blocks a clear note, go live where there are  
no roads and see yourself and poetry under your eyelids.



## ENJAMBMENT 1

Duke u përpjekur të bëj një hap drejt së shkuarës,  
pluhuri në sytë e mi,  
si pluhuri i rrugëve të fshatit tim të fëmijërisë,  
i ndal përpjekjet e mia për të kaluar nëpër pasqyrat e jetës;  
edhe orët nuk duan të më lejojnë të udhëtoj nëpër kohë.

Si Rilke, po mësoj se pesha e jetës  
është më e rëndë edhe se vetë pesha e sendeve dhe e  
mendimeve.  
Presioni i dritës së reflektuar në sytë e mi,  
i bashkuar me rezistencën e pasqyrave,  
i ndal përpjekjet e mia për të udhëtuar në kohë.

Edhe po të vendos pambuk në veshë të ndjeshëm,  
nuk ka dobi. Duhet t'i mbyll sytë,  
të kthehem në kallamishtë, të lejoj sheqerin e kallamit  
të ngrihet brenda meje, ashtu siç bëri dikur Rumi.

Pse vallë e shkuara më bën të shqetësohem?  
Ajo është një enë e gjatë bosh, me njërin skaj të mbyllur;  
duhet të frysh në të derisa të kapësh rezonancën,  
atëherë presioni i çdo çasti do të kalojë përmes saj.

Është koha ta nxjerr pambukun dhe t'i mbyll sytë,  
t'i pres e t'i thaj kallamët, të ndërtoj një fyell, të zbraz  
çdo gjë që pengon një tingull të pastër, të shkoj të jetoj atje  
ku nuk ka rrugë, dhe ta shoh veten dhe poezinë nën qepallat e  
mia.

---

<sup>1</sup> **Enjambment** (shqip: enjambman, thyerje e vargut) është teknikë poetike kur një fjali ose mendim vazhdon nga një varg në tjetrin pa u ndalur me pikë, presje apo shenjë tjetër fundore në fund të vargut të parë.



## CHASING ANDROMEDA

Clinging onto a chunk of a timber  
adrift in a turbulent lake,  
the rhythm of their pulse  
mutually replicating,  
blue waters and the maven poet  
revolved into one swaying being.

Veering at the corner of centuries  
feeling the smell of truth  
over the grim lagoon, a window into earth,  
at a place devoid of measuring devises  
where only the love dervishes meet,  
sitting in pure absence without expectations,  
lyricist began weaving thoughts' tapestry,  
gathered the art of trapping swerving planets  
between veiled space-time sheets,  
acquired to migrate remnants of time  
among its entangled layers.

Unfamiliar constellations  
ensuing through a gallery of dreams  
soared amid Milky Way's harbor-

'Chained Woman' Andromeda  
was finally free of handcuffs,  
and the music of the spheres  
began sprinting towards a new era.

Old shaman, his soul began flying  
towards places where the creation  
was working itself out, to catch onto her  
ahead of the swans begun crawling,  
before she was going to vanish in the light.



## NDJEKJA E ANDROMEDËS

Duke u kapur pas një cope druri  
që notonte në një liqen të trazuar,  
ritmi i pulsit të tyre,  
duke u pasqyruar te njëri-tjetri,  
ujërat blu dhe poeti-mjeshtër  
u shndërruan në një qenie të vetme, që lëkundej.

Duke u shmangur në kthesën e shekujve,  
duke ndier erën e së vërtetës  
mbi lagunën e zyrtë, një dritare drejt tokës,  
në një vend pa mjete matëse,  
ku takohen vetëm dervishët e dashurisë,  
të ulur në mungesë të pastër, pa pritshmëri,  
liriki filloi të endte sixhaden e mendimeve,  
mblodhi artin e kapjes së planetëve që shmangen  
mes fletëve të mbuluara të hapësirë-kohës,  
përvetësoi të migronte mbetjet e kohës  
nëpër shtresat e saj të ndërlikuara.

Yjësi të panjohura,  
që pasonin njëra-tjetrën në një galeri ëndrrash,  
u ngritën mes portit të Rrugës së Qumështit

“Gruaja e Zinxhiruar”, Andromeda,  
më në fund u çlirua nga prangat,  
dhe muzika e sferave  
filloi të vraponte drejt një epoke të re.

Shamani i vjetër, shpirti i tij nisi të fluturonte  
drejt vendeve ku krijimi  
po e përmbushte vetveten, për t’u kapur pas saj  
para se mjellmat të fillonin zvarritjen,  
para se ajo të zhdukej në dritë.



## DISSOLVING THOUGHTS

A bull plowing and sowing its truth,  
he entered into a Chinese magic-mirror,  
that reveals all sides of a human being.

Reconciling to his blue destination,  
and how quickly a sailor discovers  
himself on a sad sea, his life moving on  
between a stern and the ship's wheel,  
dissolving into nothingness, he became  
a broken ship beaten by monotonous waves  
at the bottom of the ocean of his memories.

For many years she had been gone,  
but her perfume still lingered on his couch.  
For many seasons, the train on that distant bridge  
sailed past, whistling through the unfamiliar fog.  
In so many distant cities her lonely nights  
spoke to him like a wind taking shape  
in a keyhole. He never understood why  
on such silent nights by the corridors of dreams,  
he wanted to go to her secretly. Wandered,  
was it the wind, lifting-up a corner of the evening  
under his old-fashioned hurricane lantern?

It seemed on the linden trees past year's leaves  
were still hanging, like the pages from the old  
telephone directories; their fragrance intact,  
averting him from grasping a new language.  
The remembrance of the past and anticipation  
of the future placed him between hidden folds  
of the cylindrical segments of space-time.  
With the arrival of the morning sun, he was  
going out in the spring meadows to gather lilacs.  
He was so delighted that he remained all day  
dissolving his thoughts into the season's moment.



## MENDIME QË SHKRIHEN

Një dem që lëron e mbjell të vërtetën e vet,  
ai hyri në një pasqyrë magjike kineze,  
që zbulon të gjitha anët e qenies njerëzore.

Duke u pajtuar me destinacionin e tij blu,  
dhe sa shpejt një detar e zbulon veten  
në një det të trishtuar, jeta e tij duke rrjedhur  
mes pupës dhe timonit të anijes,  
duke u shkrirë në hiç, ai u bë  
një anije e thyer, e rrahur nga valë monotone  
në fund të oqeanit të kujtimeve të tij.

Për shumë vite ajo kishte ikur,  
por parfumi i saj ende qëndronte mbi divanin e tij.  
Për shumë stinë, treni mbi atë urë të largët  
kalonte tutje, duke fishkëllyer në mjegullën e panjohur.  
Në kaq shumë qytete të largëta, netët e saj të vetmuara  
i flisnin atij si një erë që merrte trajtë  
në vrimën e çelësit. Ai kurrë nuk e kuptoi pse,  
në netë kaq të heshtura, përgjatë korridoreve të ëndrrave,  
dëshironte të shkonte tek ajo fshehurazi.  
Endej a ishte era ajo që ngrinte një cep të mbrëmjes  
nën fenerin e tij të vjetër të stuhive?

Dukej sikur në blinjhtë, gjethet e vitit të kaluar  
ende vareshin, si faqet e librave të vjetër  
të numrave telefonikë; aroma e tyre e paprekur,  
e pengonte të kapte një gjuhë të re.  
Kujtimi i së shkuarës dhe pritja e së ardhmes  
e vendosnin mes palëve të fshehta  
të segmenteve cilindrike të hapësirë-kohës.



## The outpost of the time - *Posta e kohës*

---

Me ardhjen e diellit të mëngjesit, ai  
dilte në livadhet pranverore për të mbledhur jargavanë.  
Ishte aq i gëzuar, sa që qëndroi gjithë ditën  
duke shkruar mendimet e tij në çastin e stinës.



## NOSTALGIA

Slow rain on the windowpane coupled with  
heavy fog and dense clouds of sorrow  
fill the far skies of the South.

Replicating in my eyes, gliding drops,  
empty canoes being pulled across a river,  
transport a veiled gallery of my daydreams.

Everything is blurred, the walls behind  
lie unconscious, music from the old gramophone  
float on spring wind like a driftwood on waves,  
and with sundown, its resonances thicken.

I close my eyes, a movement inwards,  
my homeward way lost beyond the horizon,  
a roar of words and intermingled notes,  
drinking darkness, I have no mind, no tongue,  
only the source of thought and words find me.

Wheels of life and passing fades like a mirage  
maybe that far mountain would bow down  
thus, I could see her again standing in the doorway,  
together to rename the stars in the sky's collection.



## NOSTALGJIA

Shi i ngadaltë mbi xhamin e dritares, i shoqëruar me  
mjegull të rëndë dhe re të dendura trishtimi,  
mbushin qiellin e largët të Jugut.

Duke u pasqyruar në sytë e mi, pika që rrëshqasin,  
si kanoe të zbrazëta tërhequr përgjatë një lumi,  
transportojnë një galeri të mbuluar të ëndërrimeve të mia  
ditore.

Gjithçka është e turbullt, muret pas meje  
qëndrojnë të pavetëdijshme; muzika nga gramafoni i vjetër  
lundron në erën e pranverës si dru i rrjedhur mbi valë,  
dhe me perëndimin e diellit, jehona e saj trashet.

Mbyll sytë, një lëvizje nga brenda,  
rruga ime për në shtëpi humbet përtej horizontit,  
një gjëzim fjalësh dhe notash të ndërthurura;  
duke pirë errësirën, s'kam mendje, s'kam gjuhë,  
vetëm burimi i mendimit dhe fjalës më gjen.

Rrotat e jetës dhe kalimi zbehen si një mirazh;  
ndoshta ai mal i largët do të përkulet,  
që ta shoh përsëri atë në prag të derës,  
së bashku për t'i riemërtuar yjet në koleksionin e qiellit.



## RENAMING THE STARS

Fog arising over old wedding picture's glass surface  
at grandma's shed in the mountain village-  
slow rain form upon it, gliding drops arising,  
each carrying a gallery of dreams  
slide like empty canoes pulled down the Koban River.

Everything is blurred in my eyes, the walls behind  
lie unconscious, music from the old gramophone  
float on spring wind like driftwood on waves.  
I enter a gallery of dreams. I go out of the darkness  
onto a road of darkness, saw this then that.

I saw that then this, wondered if only the world  
would always remain intact, as if some fisherman  
drawing a little dinghy up the Koban's shore.  
I close my eyes, a movement inwards,  
a roar of words and intermingled notes-  
drinking darkness, I have no mind, no tongue,  
only the source of thought and words find me.

Wheels of life and passing fades like a mirage  
maybe the mountain Elbrus would bow down  
so, I could see her again standing in our doorway,  
together rename the stars in the sky's collection.



## RIEMËRTIMI I YJEVE

Mjegull që ngrihet mbi xhamin e një fotografie të vjetër  
dasme  
në kasollen e gjyshes në fshatin malor  
shi i ngadaltë formohet mbi të, pika që rrëshqasin,  
secila duke mbajtur një galeri ëndrrash,  
rrëshqasin si kanoe të zbrazëta të tërhequra përgjatë lumit  
Koban.

Gjithçka është e turbullt në sytë e mi; muret pas  
qëndrojnë të pavetëdijshme; muzika nga gramafoni i vjetër  
lundron në erën e pranverës si dru i rrjedhur mbi valë.  
Hyj në një galeri ëndrrash. Dal nga errësira  
në një rrugë errësire, pashë këtë, pastaj atë.

Pashë atë, pastaj këtë; mendova sikur bota  
të mbetej gjithmonë e paprekur, si një peshkatar  
që tërheq një varkë të vogël në brigjet e Koban-it.  
Mbyll sytë, një lëvizje nga brenda,  
një gjënim fjalësh dhe notash të ndërthurura  
duke pirë errësirën, s'kam mendje, s'kam gjuhë,  
vetëm burimi i mendimit dhe fjalës më gjen.

Rrotat e jetës dhe kalimi zbehen si mirazh;  
ndoshta mali Elbrus do të përkulet,  
që ta shoh përsëri atë në pragun tonë,  
së bashku për t'i riemërtuar yjet në koleksionin e qiellit.



## AT THE OUTPOST

Positive slope of memory led me to the night stars,  
negative one had me slide into a deep ocean in a dream,  
to a place where the nine spheres of heaven were drowned,  
where pearls sparkled, their beauty never touched the surface-  
I could only hear their dazzling echoes.

Over a flat line, extending east and west,  
love crawled in silence, soul became a night owl,  
roads overflowed with drunkards and winos, all plastered on love.

I stood as a flag at the center of a nearly flat space,  
sensing ahead the coming storm, befriending moving clouds,  
scrutinizing the ocean waves licking the shore, hearing the  
winds singing in lonely alleys, sporadic trains transporting  
loads and souls, carrying the dismal dimensions of day's news  
to cities of tomorrow.

Unable to lift my head to see the afternoon sun and evening  
stars, glancing left and right, I observed things of the world that  
did not move:

Houses, mountains, blue inlets, rooftops, chimneys, treetops,  
fences, and doors resisting the years. My flower-like human  
heart withered in that world, my flesh being wasted by longing.

I sat in that silence like an old lover, with one moment  
life was an ancient rock in me, the next, an all-absorbing black  
hole- I could only crawl out from the rocks and stones.

During the periods of immense hurricanes, utterly alone,  
flattened by the winds and troubled as the sea, got to know the  
storm,  
thought of the days before I met her, when I had no troubles at  
all. . .



## NË POSTËN E PARË

Pjerrësia pozitive e kujtesës më çoi drejt yjeve të natës,  
ajo negative më rrëshqiti në një oqean të thellë në ëndërr,  
në një vend ku nëntë sferat e qiellit ishin mbytur,  
ku perlat shkëlqenin, bukuria e tyre kurrë nuk prekte sipërfaqen  
mund të dëgjoja vetëm jehonat e tyre verbuese.

Mbi një vijë të rrafshët, që shtrihej lindje–perëndim,  
dashuria zvarritej në heshtje, shpirti bëhej buf nate,  
rrugët vërshonin nga të dehur e pijanecë, të gjithë të ngjitur pas  
dashurisë.

Qëndrova si një flamur në qendër të një hapësire pothuajse të  
sheshtë, duke ndier përpara stuhinë që po vinte, duke u  
miqësuar me retë lëvizëse, duke vëzhguar dallgët e oqeanit që  
lëpinin bregun, duke dëgjuar erërat që këndonin në rrugica të  
vetmuara, trenat sporadikë që bartnin ngarkesa e shpirtra,  
duke çuar përmasat e zymta të lajmeve të ditës në qytetet e së  
nesërmes.

I paaftë të ngrija kokën për të parë diellin e pasdites dhe yjet e  
mbrëmjes, duke hedhur sytë majtas e djathtas, vëzhgoja gjërat e  
botës që nuk lëviznin:

shtëpi, male, gjire blu, çati, oxhaqe, maja pemësh,  
gardhe dhe dyer që u rezistonin viteve. Zemra ime njerëzore, si  
lule, u vyshk në atë botë, mishi im i tretur nga mallëngjimi.

U ula në atë heshtje si një i dashuruar i vjetër;  
në një çast jeta ishte një shkëmb i lashtë brenda meje,  
në tjetrin një vrimë e zeze që përpinte gjithçka  
mund të zvarritesha vetëm përmes shkëmbinjve dhe gurëve.  
Gjatë periudhave të uraganeve të mëdha, krejtësisht i vetëm,  
i sheshuar nga erërat dhe i trazuar si deti, njoha stuhinë,  
mendova për ditët para se ta takoja atë, kur s'kisha aspak  
brenge...



## ON THE OTHER SIDE

Positive slope of memory  
lead me to the night stars,  
negative one has me slide  
into a deep ocean in a dream,  
to a place where nine spheres  
of heavens are drowned,  
where pearls sparkle, their beauty  
never touch the surface.  
I hear only their dazzling echoes.

Over a flat line, extending  
east and west (along x-axis),  
love crawls in silence,  
soul becomes a night owl,  
roads overflow with drunkards  
and winos, all plastered on love.

I stand as a flag at the center  
of a nearly flat space,  
sensing ahead the coming storm,  
befriended by moving clouds  
and occasional birds, watching  
the ocean waves licking the shore,  
hearing the winds singing in lonely alleys,  
sporadic trains carrying loads and souls.

Unable to lift my head to see  
the afternoon sun and evening stars,  
glancing left and right, observe  
things of the world that do not move:  
Houses, mountains, blue inlets,  
rooftops, chimneys, treetops,  
fences and doors resisting the years.



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

I sit in that silence like old lovers,  
with one moment, my life is a stone in me,  
and the next, an all-absorbing black hole.

During the periods of immense hurricanes,  
utterly alone, flattened by the winds,  
troubled as the sea, I get to know the storm,  
think of the days before I met her,  
when I seemed to have had no troubles at all.



## NË ANËN TJETËR

Pjerrësia pozitive e kujtesës  
më çon drejt yjeve të natës,  
ajo negative më rrëshqit  
në një oqean të thellë në ëndërr,  
në një vend ku nëntë sferat  
e qiellit janë mbytur,  
ku perlat shkëlqejnë, bukuria e tyre  
kurrë nuk prek sipërfaqen.  
Dëgjoj vetëm jehonat e tyre verbuese.

Mbi një vijë të rrafshët, që shtrihet  
lindje–perëndim (përgjatë boshtit x),  
dashuria zvarritet në heshtje,  
shpirti bëhet buf nate,  
rrugët vërshojnë nga të dehur  
e pijanecë, të gjithë të ngjitur pas dashurisë.

Qëndroj si një flamur në qendër  
të një hapësire pothuajse të sheshtë,  
duke ndier përpara stuhinë që vjen,  
i shoqëruar nga retë lëvizëse  
dhe zogjtë e rrallë, duke parë  
dallgët e oqeanit që lëpijnë bregun,  
duke dëgjuar erërat që këndojnë në rrugica të vetmuara,  
trenat sporadikë që bartin ngarkesa e shpirtra.

I paaftë të ngre kokën për të parë  
diellin e pasdites dhe yjet e mbrëmjes,  
duke hedhur sytë majtas e djathtas, vëzhgoj  
gjërat e botës që nuk lëvizin:  
shtëpi, male, gjire blu,  
çati, oxhaqe, maja pemësh,  
gardhe e dyer që u rezistojnë viteve.



Ulem në atë heshtje si të dashuruar të vjetër;  
në një çast jeta ime është një gur brenda meje,  
në tjetrin, një vrimë e zezë që përpin gjithçka.

Gjatë periudhave të uraganeve të mëdha,  
krejtësisht i vetëm, i sheshuar nga erërat,  
i trazuar si deti, e njoh stuhinë,  
mendoj për ditët para se ta takoja atë,  
kur më dukej se s'kisha fare brenga.



## TO PASS THROUGH TIME

During my youth, I was a planet with its hills,  
forests, mountains, and four seasons,  
where old desires flared,  
descending rays broke into rainbows,  
farmers sow the prospering fields,  
and the moon colored the future's lips.

Now, extinct, shriveled under a rolled-up blanket,  
no longer having rainbows  
and having lost that childhood energy,  
with a drying lake creeping beside me  
incapable of reflecting the sun's rays.

Having lost my voice, dark shadows carry me  
like an old trumpet in its black case.  
I am resembling a compass needle  
a long-distance runner carries as he runs  
with his heart pounding,  
having his words decomposed  
under the ruins of his dreams.

And this thunder in my soul. I am unaware  
to what port or to what ancient tomb  
is this damn storm taking me?  
Who would listen to my cries,  
under lightning and the wind,  
except the turbulent waves in my soul?

I must awaken from this bad dream,  
open wide the third eye, even in this cold  
to observe the moon proceeding overhead  
and the stars made of snow, be able  
to readjust my time to pass through time.



## TË KALOSH NËPËR KOHË

Në rininë time isha një planet me kodra,  
pyje, male dhe katër stinë,  
ku dëshirat e vjetra shpërthenin,  
rrezet që zbresnin thërrmoheshin në ylberë,  
bujqit mbillnin fusha pjellore,  
dhe hëna ngjyrote buzët e së ardhmes.

Tani, i shuar, i tkurrur nën një batanije të mbledhur,  
pa më ylberë  
dhe me energjinë e fëmijërisë të humbur,  
me një liqen që thahet duke u zvarritur pranë meje,  
i paaftë të pasqyrojë rrezet e diellit.

Duke e humbur zërin, hijet e errëta më mbartin  
si një trumpetë e vjetër në kutinë e saj të zezë.  
I ngjaj gjilpërës së një busulle  
që një vrapues i distancave të gjata e mban teksa vrapon,  
me zemrën që i rreh fort,  
fjalët e tij të shpërbëra  
nën rrënojat e ëndrrave.

Dhe ky bubullimë në shpirtin tim. Nuk e di  
drejt cilit port apo cilit varr të lashtë  
po më çon kjo stuhi e mallkuar?  
Kush do t'i dëgjonte thirrjet e mia,  
nën vetëtima dhe erë,  
përveç dallgëve të trazuara në shpirtin tim?

Duhet të zgjohem nga kjo ëndërr e keqe,  
të hap gjerë syrin e tretë, edhe në këtë të ftohtë,  
të vëzhgoj hënën që kalon sipër  
dhe yjet prej bore, të jem në gjendje  
ta rirregulloj kohën time për të kaluar nëpër kohë.



## AT THE OUTPOST

The ascending road of memory led me to the heavens,  
downhill I slid into a deep ocean in a dream,  
to a place where the nine spheres of heaven were drowned,  
where pearls sparkled, their beauty never reached the  
surface.

I could only hear their dazzling echoes.

Time's fool, I was seeking the infinite and inexplicable,  
spurning everything that has an end, at a place  
where love crawled in silence, soul became a night owl,  
roads overflow with drunkards plastered on love.

I stood as a flag atop a pole at the center of a lot,  
sensing ahead the coming storm, befriending moving clouds,  
scrutinizing the ocean waves licking the shore,  
hearing the winds whispering in lonely alleys  
whistles of sporadic trains transporting souls,  
carrying the dismal dimensions of day's news to cities of  
tomorrow, while observing things in the world that did not  
move: houses, mountains, blue inlets, rooftops, chimneys,  
treetops, fences and doors resisting the years.  
My flower-like human heart withered in that world.  
My flesh wasted by longing, settled in its silence like an old  
lover.

Over the vast flat plains, way off into endlessness,  
my dreamy eyes fixated on the wide horizon,  
where distances dissolved, the future opened,  
the past streamed in a mist,  
villages and towns dissipated in its wake.

During the periods of immense hurricanes, utterly alone,  
flattened by the winds and troubled as the sea, got to know  
the storm,



reflecting on the days before I met her, when I had no troubles at all.

In love with the lifting wind, oscillating, with no load in my back, no baskets in my arms, the sky above, and the earth around me, sometimes touched by the shadows of the floating clouds, at times, visited by rains that wet us- we whistled together, the rain and I conversed as we dried in the sun.

I whistled a falcon's song, my soul in his sky screeched out up from the rock of his body, flying free above the earth, whilst life in me oscillated between rocks and all-absorbing black holes-  
I could only crawl out from the rocks and stones.



## NË POSTËN E PARË

Rruga ngjitëse e kujtesës më çoi drejt qiejve,  
tatëpjetë rrëshqita në një oqean të thellë në ëndërr,  
në një vend ku nëntë sferat e qiellit ishin mbytur,  
ku perlat shkëlqenin, por bukuria e tyre kurrë s'arriti  
sipërfaqen.

Mund të dëgjoja vetëm jehonat e tyre verbuese.  
I marrë i kohës, kërkoja të pafundmen dhe të  
pashpjegueshmen, duke përbuzur gjithçka që ka një fund, në  
një vend ku dashuria zvarritej në heshtje, shpirti bëhej buf  
nate, rrugët vërshonin nga të dehur të ngjitur pas dashurisë.

Qëndrova si një flamur mbi një shtizë në qendër të një  
hapësire, duke ndier përpara stuhinë që po vinte, duke u  
miqësuar me retë lëvizëse, duke vëzhguar dallgët e oqeanit  
që lëpinin bregun, duke dëgjuar erërat që pëshpëritnin në  
rrugica të vetmuara, fishkëllimat e trenave sporadikë që  
bartnin shpirtra, duke çuar përmasat e zymta të lajmeve të  
ditës në qytetet e së nesërme,  
ndërsa vëzhgoja gjërat e botës që nuk lëviznin:  
shtëpi, male, gjire blu, çati, oxhaqe, maja pemësh,  
gardhe e dyer që u rezistonin viteve.  
Zemra ime njerëzore, si lule, u vyshk në atë botë.  
Mishi im, i tretur nga mallëngjimi, u vendos në heshtjen e  
saj si një i dashuruar i vjetër.

Mbi rrafshinat e gjera, larg në pafundësi,  
sytë e mi ëndërrimtarë u ngulën në horizontin e gjerë,  
ku largësitë treten, e ardhmja hapej,  
e shkuara rridhte në mjegull,  
fshatra e qytete shpërndaheshin pas saj.

Gjatë periudhave të uraganeve të mëdha, krejtësisht i vetëm,  
i sheshuar nga erërat dhe i trazuar si deti, njoha stuhinë,



duke reflektuar mbi ditët para se ta takoja atë, kur s'kisha fare brenga.

I dashuruar pas erës që ngrihej, duke u lëkundur, pa barrë në shpinë, pa shporta në krahë, me qiellin mbi mua dhe tokën rreth meje, herë i prekur nga hijet e reve që notonin, herë i vizituar nga shirat që na lagën fishkëllënim së bashku, shiu dhe unë bisedonim teksa thaheshim në diell.

Fishkëllova këngën e një skifteri; shpirti im në qiellin e tij klithi, duke u ngritur nga shkëmbi i trupit të tij, duke fluturuar i lirë mbi tokë, ndërsa jeta në mua lëkundej mes shkëmbinjve dhe vrimave të zeza që përpijnë gjithçka mund të zvarritesha vetëm përmes shkëmbinjve dhe gurëve.



## PASSING THE TORCH

I have tried in vain but never succeeded  
refracting sideways through a mirror  
where I imagined I would meet  
thieves, ghosts I have never known,  
and poets possessing stony words  
plunging abruptly from their lips,  
those mythological fishermen  
casting out their huge nets to catch dreams,  
nomads in search of new pastures.  
I even tried passing through its  
flintlike silvery layers, not succeeding,  
a farsighted man, only acknowledging  
everything close to his face is a stone.

Once, I thrived on becoming a chemist,  
struggling to dismantle double-sided mirrors.  
During such tries learned how to see  
further into the paintings, and even got closer  
to the spaces where language cannot reach.  
As a result, became aware that no river  
can revisit its source, nor the apples return  
to the tree from which they had fallen.

This obscure mirror, which reflected my heart  
like a face at the bottom of a well,  
I will now offer it to you, my friend, hoping  
it will assist you in getting to know your heart  
as you ascend on the veiled ladder deep into it.



## DORËZIMI I FLAKADANIT

Jam përpjekur më kot, por kurrë s'ia dola  
të thyhesha anash përmes një pasqyre  
ku përfytyroja se do të takoja  
hajdutë, fantazma që s'i kam njohur kurrë,  
dhe poetë me fjalë prej guri  
që binin befas nga buzët e tyre,  
ata peshkatarë mitologjikë  
që hedhin rrjeta të mëdha për të kapur ëndrra,  
nomadë në kërkim të kullotave të reja.  
Provova madje të kaloja përmes  
shtresave të saj argjendore, si stralli, por pa sukses,  
një njeri largpamës, që pranon vetëm  
se gjithçka pranë fytyrës së tij është gur.

Njëherë, lulëzova duke u bërë kimist,  
duke u përpjekur të çmontoja pasqyra dykahëshe.  
Gjatë këtyre përpjekjeve mësova të shoh  
më thellë në piktura dhe madje u afrova  
hapësirave ku gjuha nuk arrin.  
Si përfundim, u bëra i vetëdijshëm se asnjë lumë  
s'mund të rikthehet te burimi i vet, as mollët  
të kthehen në pemën nga e cila kanë rënë.

Këtë pasqyrë të errët, që ma pasqyroi zemrën  
si një fytyrë në fund të një pusi,  
tani po ta ofroj ty, miku im, me shpresë  
se do të të ndihmojë të njohësh zemrën tënde  
ndërsa ngjitesh në shkallën e mbuluar thellë brenda saj.



## **DERVISH MEETS KELMENDI, THE THUNDERHEAD**

Old dervish, his shadow casting from the North,  
rested by day and traveled by night  
climbed up into the sky without a ladder.

Above the treetops, he met with Thunderhead,  
sighted cumulonimbus, a massive, towering cloud  
full of heavy rain, thunderstorms, and lightning.

Having been lost in the sky of his own verse,  
in the presence of the dervish, Thunderhead  
endlessly down poured as a wet monsoon,  
gave new colors to unfamiliar rainbows,  
stashing and leaving behind new patterns  
emerging out of the ancient tales of the West,  
while twirling and dancing in yesterday's wind.  
Verses emanating from his lips as slanted rain  
consistently wetted the opposite shores.

Trying like the earth to catch a glimpse  
of his falling words, the dervish became  
a lonely linden tree, lending its new shadow  
to his surroundings, attract occasional bees,  
lean back, knowing he would never have a chance  
to fall like rain, but all he could ever do  
was to allow thunder's wind to turn his pages.



## **DERVISHI TAKON KELMENDIN, REJA E BUBULLIMËS**

Dervishi i vjetër, me hijen që i binte nga Veriu,  
pushonte ditën dhe udhëtonte natën,  
u ngjit në qiell pa shkallë.

Mbi majat e pemëve, u takua me Re-në e Bubullimës,  
pa kumulonimbusin, një re gjigante, madhështore,  
plot shi të rëndë, stuhi dhe vetëtima.

I humbur në qiellin e vargut të vet,  
në praninë e dervishit, Reja e Bubullimës  
u derdh pa pushim si një muson i lagësht,  
i dha ngjyra të reja ylberëve të panjohur,  
duke fshehur e lënë pas modele të reja  
që dilnin nga tregimet e lashta të Perëndimit,  
ndërsa rrotullohej e kërcente në erën e djeshme.  
Vargjet që dilnin nga buzët e tij, si shi i pjerrët,  
lagin pa ndërprerje brigjet përballë.

Duke u përpjekur, si toka, të kapte një vështrim  
të fjalëve që binin, dervishi u bë  
një blinë e vetmuar, duke dhuruar hijen e saj të re  
për rrethin, duke tërhequr herë pas here bletë,  
u mbështet, duke e ditur se kurrë s'do të kishte rast  
të binte si shi, por gjithçka që mund të bënte  
ishite të lejonte erën e bubullimës t'ia kthente faqet.



## SOWER

*Dedicated to a dear friend and poet, Lulzim Tafa*

The majestic sun rises differently each day,  
soul's dance twirls in its changing light,  
in his evenings, trying to imitate the sun,  
the moon reveals itself in different guises.

Carrying his prayer rug on his shoulders  
the sage, viewing the crescent moon  
drinking up the empty sky-  
while roaming around the globe  
and lighting up the night's darkness,  
tries to unearth beneath ancient memories  
the incredible histories of yesteryears,  
the secret miracles of the days to come.

Each evening, the moon exhibits  
a different mask that does not weep,  
affecting the mystic's pirouetting words  
in search of their spiritual roots.

Hiding behind his third eye, gazing into time,  
wearing his blue khirqah, the scholar-mystic  
surveys his words adjusting their clothes,  
trying to find their way into new poems,  
trading places with strangers of the night.

His newly arrived poems sprint with a limp  
toward the square moon guarding the past.  
A new window he produced makes a frame,  
on its other side--- he catches himself  
surrendering to the syllables counted on his fingers  
under the silence of his freshly created spectra.



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

While awaiting the boundless twilight,  
his soul flatters into a conductor tattooing darkness,  
his time-shaken words, like a flock of birds  
lift into flight to fill our eyes and ears  
gazing into space-time, causing our psyche  
to flow nameless and free.



## **MBJELLËSI**

*(Kushtuar miku të dashur dhe poetit, Lulzim Tafa)*

Dielli madhështor lind ndryshe çdo ditë,  
vallja e shpirtit rrotullohet në dritën e tij që ndryshon;  
në mbrëmjet e tij, duke u përpjekur ta imitojë diellin,  
hëna shfaqet në pamje të ndryshme.

Duke mbajtur sexhaden e lutjes mbi supe,  
i urti, duke vështruar hënën në rritje,  
duke pirë qiellin e zbrazët,  
ndërsa endet rreth globit  
dhe ndriçon errësirën e natës,  
përpiqet të nxjerrë nga thellësitë e kujtimeve të lashta  
historitë e pabesueshme të djeve,  
mrekullitë e fshehta të ditëve që do të vijnë.

Çdo mbrëmje, hëna shfaq  
një maskë tjetër që nuk qan,  
duke ndikuar fjalët rrotulluese të mistikut  
në kërkim të rrënjëve të tyre shpirtërore.

I fshehur pas syrit të tij të tretë, duke soditur kohën,  
i veshur me hirkan blu, dijetari-mistik  
vëzhgon fjalët e tij, duke u rregulluar petkat,  
duke kërkuar rrugën drejt poezive të reja,  
duke ndërruar vend me të panjohurit e natës.

Poezitë e sapoardhura vrapojnë çalamane  
drejt hënës katrore që ruan të shkuarën.  
Një dritare e re që ai krijoi bëhet kornizë;  
në anën tjetër e gjen veten  
duke iu dorëzuar rrokjeve të numëruara në gishta,  
nën heshtjen e spektrave të sapokrijuara.



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

Teksa pret muzgjet pa kufi,  
shpirti i tij shndërrohet në dirigjent që gdhend errësirën;  
fjalët e tij, të tronditura nga koha, si një tufë zogjsh,  
ngrihen në fluturim për të mbushur sytë dhe veshët tanë,  
duke soditur hapësirë-kohën,  
duke bërë që psika jonë të rrjedhë pa emër dhe e lirë.



## RACONTEUR

In a dream, cut from dissipated shades  
while gliding on the surface of a frozen stream,  
wondering if waters were still flowing underneath,  
he wanted to reach the shore to unite  
and become one again with his own shadow.  
Walking on slippery ice, he had just realized  
how a part of the world leaves the world,  
but the wetness never leaves the water.

When he reached the shore full of snow  
happy to unite with his old shadow,  
felt it was fitting and better for a sailor  
to leave his adventures to the waters  
even if they were frozen.

Hoping to reach his cabin in the thick snow  
began following someone's footprints,  
at times deep, sometimes shallow.  
From a man's footprints, one can't figure out  
what he was carrying, but it didn't matter.

He finally reached his chalet. Carrying into it  
some old logs, built a fire, lit up a cigar,  
and after sipping his cognac, munching on  
a piece of bread, began writing.  
His soul got busy opening the creation core,  
secrets within started to slide forth.

Trying to explore the foundations  
and the implication of mathematics,  
examining the movements such as  
fictional truths, puzzles about belief,  
and his probes into reference and existence,



## **The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

he wanted to transmit math's relationship  
to the reality and logic of present times.  
His words, absorbed deep into the earth  
readied to give life to waiting young forests.

Throwing new logs into the fireplace,  
stretched out on his couch and closed his eyes.  
He was setting out on a journey with new ideas,  
realizing new ideas, too, will age with journeys.



## RRËFIMTARI

Në një ëndërr, e prerë nga hije që shpërndahen,  
duke rrëshqitur mbi sipërfaqen e një përroi të ngrirë,  
duke u pyetur nëse ujërat ende rridhnin poshtë,  
ai deshi të arrinte bregun për t'u bashkuar  
dhe për t'u bërë sërish një me hijen e vet.  
Duke ecur mbi akull të rrëshqitshëm, kuptoi sapo  
se si një pjesë e botës e lë botën,  
por lagështia kurrë nuk e lë ujin.

Kur arriti bregun plot dëborë,  
i lumtur të ribashkohej me hijen e vjetër,  
ndjeu se ishte e drejtë dhe më mirë për një detar  
t'ua linte aventurat ujërave,  
edhe nëse ishin të ngrira.

Duke shpresuar të arrinte kasollen në dëborë të dendur,  
filloi të ndiqte gjurmët e dikujt,  
herë të thella, herë të cekëta.  
Nga gjurmët e një njeriu nuk mund të kuptohet  
çfarë mbante, por kjo s'kishte rëndësi.

Më në fund arriti te shtëpiza alpine. Duke futur brenda  
disa trungje të vjetër, ndezi zjarrin, ndezi një puro,  
dhe pasi piu një gllënjë konjak, duke kafshuar  
një copë bukë, filloi të shkruante.  
Shpirti i tij u mor me hapjen e bërthamës së krijimit;  
sekretet brenda nisën të rrëshqisnin përpara.

Duke u përpjekur të eksploronte themelet  
dhe domethënien e matematikës,  
duke shqyrtuar lëvizje si  
të vërteta fiktive, enigma besimi,  
dhe kërkimet e tij mbi referencën dhe ekzistencën,



ai donte të përcillte marrëdhënien e matematikës  
me realitetin dhe logjikën e kohës së sotme.  
Fjalët e tij, të përthithura thellë në tokë,  
u përgatitën t'u japin jetë pyjeve të rinj që prisnin.

Duke hedhur trungje të rinj në oxhak,  
u shtri në divan dhe mbylli sytë.  
Po nisej në një udhëtim me ide të reja,  
duke e kuptuar se edhe idetë e reja plaken me udhëtimet.



## UNDER THE EXILE OF SHADOWS

Wherever I go, my shadow carries me  
and writing means letting the words rest  
and sleep on that thin rug of no depth,  
which, like the soul, has all the strength,  
and the entire wisdom of earthly silence.

I wait for the night's arrival to lose my shadow,  
grow wings, collect my words, and in the dark  
when the sky is covered with rain clouds  
fly and land on a nearby tree, spread the wet words  
over its green leaves. Having exiled my moist words,  
in the night when I too am a shadow and hollow,  
letting my claws portion out the shades,  
once being a corolla to the conjugate,  
and watching the night's shadow of shadows,  
with the darkness spreading all over the world,  
I finally perceive I must exchange  
the shadows of my closed eyelids for my soul.

Nothing any longer takes shape or form outside me-  
came to realize one must always have shadow and light.

Knowing that shadows lie deep in me and voiceless  
whether a bird on a tree, or a man on the ground,  
I must become a tailor with a torn shirt of shadows  
mend my soaked words on it, and practice my art.



## NË MËRGIMIN E HIJEVE

Kudo që shkoj, hija ime më bart,  
dhe të shkruarit do të thotë t'i lësh fjalët  
të pushojnë e të flenë mbi atë sexhade të hollë pa thellësi,  
që, si shpirti, ka gjithë fuqinë  
dhe gjithë urtësinë e heshtjes tokësore.

Pres ardhjen e natës për të humbur hijen time,  
për të rritur krahë, për të mbledhur fjalët, dhe në errësirë,  
kur qielli mbulohet me re shiu,  
të fluturoj e të ulem në një pemë pranë,  
t'i shtrij fjalët e lagështa mbi gjethet e saj të gjelbra.  
Duke i mërguar fjalët e mia të njoma,  
në natën kur edhe unë jam hije dhe zbrazëti,  
duke lejuar kthetrat e mia të ndajnë nuancat,  
dikur kur isha një kurorëzë për të përbashkëtën,  
dhe duke vështruar hijen e natës mbi hijet,  
me errësirën që shtrihet mbi gjithë botën,  
më në fund kuptoj se duhet të ndërroj  
hijet e qepallave të mia të mbyllura me shpirtin tim.

Asgjë më nuk merr formë apo trajtë jashtë meje  
kuptova se njeriu duhet gjithmonë të ketë hije dhe dritë.

Duke e ditur se hijet qëndrojnë thellë në mua dhe pa zë,  
qoftë zog në pemë apo njeri mbi tokë,  
duhet të bëhem robaqepës me një këmishë hijesh të grisur,  
t'i qep mbi të fjalët e mia të lagura dhe të ushtroj artin tim.



## PLAY AND LET PLAY

Walking on snow  
hit by a freezing wind,  
teeth vibrating  
like a tuning fork  
send out sounds  
no one hears  
except for the mountain  
covered in white  
vanishing slowly  
without wobbling  
under the blizzard.

In that silence  
from far away  
an answer arrives,  
creeps in and  
out of my coat.

My body, too,  
begins to shake.  
A different pitch  
comes to life,  
a new resonance.

Entering my chalet  
putting fire into logs  
after warming up,  
I place my fingers  
on my guitar's strings  
and at once  
the thirst for horizons  
instantly begins.



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

Sunk in the fog  
of the memory of snow,  
I am letting music  
loosening my deafness  
to the spirit of the evening,  
while the faucets drip-drop  
a different drummer  
keeps the beats to my song.



## LUAJ DHE LËRE TË LUAJË

Duke ecur mbi dëborë,  
i goditur nga një erë ngrirëse,  
dhëmbët dridhen  
si një pirun akordimi,  
dërgojnë tinguj  
që askush s'i dëgjon  
përveç malit  
të mbuluar në të bardhë,  
që zhduket ngadalë  
pa u lëkundur  
nën stuhinë e borës.

Në atë heshtje,  
nga larg  
vjen një përgjigje,  
zvarritet brenda  
e jashtë palltos sime.

Edhe trupi im  
nis të dridhet.  
Një lartësi tjetër  
merr jetë,  
një rezonancë e re.

Duke hyrë në shtëpizën time alpine,  
duke vënë zjarrin te trungjet,  
pasi ngrohëm,  
vendos gishtat  
mbi telat e kitarës sime  
dhe menjëherë  
etja për horizonte  
nis pa vonesë.



I zhytur në mjegullën  
e kujtesës së dëborës,  
e lë muzikën  
të më zgjidhë shurdhërinë  
ndaj shpirtit të mbrëmjes,  
ndërsa rubinetat pikë-pikë,  
një daullxhi tjetër  
i mban ritmin këngës sime.



## **FOLLOWING THE SCENT OF ESCAPED WORDS**

Wearing colorful robes, strange new verses  
are fervently trying to enter my gloomy room  
through its partially open window in a storm.  
My house cats Clippy and Pumpernickle,  
whiskers oscillating, tails wagging,  
share that windowsill with my Spider Plant.

Settled on my writing desk, a word-tailor  
hoping to seize a few of verse's whispers,  
wishing to embroider them quietly  
onto my oriental tablecloth,  
like a spider, I patiently wait to capture a few.  
One is capable of performing such feats  
when all sounds in a room are in a slow flight.

Hearing the ongoing perplexing conversations  
at a wild wonder of those tranquil moments,  
my cats suddenly congregate upon my table,  
placing their toes upon the new verses.

They begin hearing strange conversations  
going on between me and my tablecloth.  
With both hands, I begin to stroke my cats.  
Together, we watch the words move  
to new locations under the kilim on the floor.  
The ease of their flow never freezes.

I get up, feed my cats, give them water,  
while they munch, I lift the corner of the rug,  
discovering words had already escaped  
but they had left their fragrance behind.



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

Spider plant, watching the show with open eyes,  
sees my pen quietly lie still over the table,  
and as it happens only in oriental tales,  
it whispers: do not grieve, dear tailor,  
anything you lose comes round in another form.

Ah, the scent of those lost words now fallen  
into the cracks between the floor panes,  
they have sunk weightlessly into the future,  
I know they still exist, so I go in search. . .



## DUKE NDJEKUR AROMËN E FJALËVE TË ARRATISURA

Të veshura me petka shumëngjyrëshe, vargje të reja e të  
çuditshme përpiqen me zjarr të hyjnë në dhomën time të  
zymtë përmes dritares gjysmë të hapur, mes një stuhie.  
Macet e mia të shtëpisë, Clippy dhe Pumpernickle,  
me mustaqe që lëkunden e bishta që tundin,  
ndajnë pragan e dritares me bimën time Merimangë.

I vendosur te tryeza e shkrimit, një rrobaqepës fjalësh  
shpreson të kapë disa pëshpëritje vargësh,  
duke dëshiruar t'i qëndisë në heshtje  
mbi mbulesën time orientale të tryezës;  
si një merimangë, pres me durim të kap disa.  
Një gjë e tillë është e mundur  
kur të gjitha tingujt në dhomë fluturojnë ngadalë.

Duke dëgjuar bisedat e vazhdueshme, të çuditshme,  
në mrekullinë e egër të atyre çasteve të qeta,  
macet e mia papritur mblidhen mbi tryezë,  
duke vendosur putrat mbi vargjet e reja.

Ato fillojnë të dëgjojnë biseda të pazakonta  
që zhvillohen mes meje dhe mbulesës së tryezës.  
Me të dyja duart filloj t'i ledhatoj macet.  
Së bashku shohim fjalët që lëvizin  
në vende të reja nën qilimin e dyshemesë.  
Lehtësia e rrjedhës së tyre kurrë nuk ngrin.

Ngrihem, ushqej macet, u jap ujë;  
tekrsa ato përtypin, ngrit një cep të qilimit,  
dhe zbuloj se fjalët kishin ikur tashmë,  
por kishin lënë pas aromën e tyre.



Bima Merimangë, duke e parë shfaqjen me sy hapur,  
sheh stilolapsin tim të qëndrojë qetë mbi tryezë,  
dhe siç ndodh vetëm në përrallat orientale,  
më pëshpërit: mos u trishto, o rrobaqepës i dashur,  
çdo gjë që humb kthehet sërish në një formë tjetër.

Ah, aroma e atyre fjalëve të humbura, tani të rëna  
në çarjet mes dërrasave të dyshemesë,  
janë zhytur pa peshë në të ardhmen;  
e di se ende ekzistojnë, prandaj nis t'i kërkoj...



## DUKE NDJEKUR AROMËN E FJALËVE TË ARRATISURA

Të veshura me petka shumëngjyrëshe, vargje të reja e të  
çuditshme përpiqen me zjarr të hyjnë në dhomën time të  
zymtë përmes dritares gjysmë të hapur, mes një stuhie.  
Macet e mia të shtëpisë, Clippy dhe Pumpernickle,  
me mustaqe që lëkunden e bishta që tundin,  
ndajnë pragan e dritares me bimën time Merimangë.

I vendosur te tryeza e shkrimit, një rrobaqepës fjalësh  
shpreson të kapë disa pëshpëritje vargësh,  
duke dëshiruar t'i qëndisë në heshtje  
mbi mbulesën time orientale të tryezës;  
si një merimangë, pres me durim të kap disa.  
Një gjë e tillë është e mundur  
kur të gjitha tingujt në dhomë fluturojnë ngadalë.

Duke dëgjuar bisedat e vazhdueshme, të çuditshme,  
në mrekullinë e egër të atyre çasteve të qeta,  
macet e mia papritur mblidhen mbi tryezë,  
duke vendosur putrat mbi vargjet e reja.

Ato fillojnë të dëgjojnë biseda të pazakonta  
që zhvillohen mes meje dhe mbulesës së tryezës.  
Me të dyja duart filloj t'i ledhatoj macet.  
Së bashku shohim fjalët që lëvizin  
në vende të reja nën qilimin e dyshemesë.  
Lehtësia e rrjedhës së tyre kurrë nuk ngrin.

Ngrihem, ushqej macet, u jap ujë;  
tekrsa ato përtypin, ngrit një cep të qilimit,  
dhe zbuloj se fjalët kishin ikur tashmë,  
por kishin lënë pas aromën e tyre.



Bima Merimangë, duke e parë shfaqjen me sy hapur,  
sheh stilolapsin tim të qëndrojë qetë mbi tryezë,  
dhe siç ndodh vetëm në përrallat orientale,  
më pëshpërit: mos u trishto, o rrobaqepës i dashur,  
çdo gjë që humb kthehet sërish në një formë tjetër.

Ah, aroma e atyre fjalëve të humbura, tani të rëna  
në çarjet mes dërrasave të dyshemesë,  
janë zhytur pa peshë në të ardhmen;  
e di se ende ekzistojnë, prandaj nis t'i kërkoj...



## ECHO OF A TREE WITHIN THE POET'S SOUL

I am a cypress tree near the center of Pristina  
conversing without words, and sharing memories  
with a young versifier settled on my shade.  
Our heads and thoughts are lifted toward the clouds,  
our roots are embedded in the deep layers of the earth.

A few hundred years ago, an old farmer planted me  
at the edge of a river by a small village of a few homes  
built of mud and scattered rocks, these days  
grown into this modern city. I have witnessed wars,  
city changing hands under all sorts of occupying armies,  
have learned many different languages, became familiar  
with all sorts of music and songs. I have witnessed  
huge fires, destruction, and rebuilding new homes,  
watched generations of children play, invent games  
under my shadows in their colorful clothes.

I let the poet write his feelings in his notebooks,  
the only thing I can offer him are these Eolian songs,  
the humming sounds I can produce due to vibrations  
with help of my leaves, only when there are winds.

I sense ahead the wind that is coming, live it through,  
am familiar with all the steps humans and animals  
leave their mark on the snow in winter, I'm also  
an expert knowing the shapes of different snowflakes.

While the things of the world do not move, chimneys  
full of silence, doors or windows open or closed,  
I've also become familiar with migrations of birds,  
for example, storks arriving from Africa during spring,  
produce their siblings and teach them to fly  
before flying back home at the end of the fall season.



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

Knowing well ahead of the coming storm, my soul is  
as troubled as the river next to me. I have hidden eyes  
resembling the eyes of a vigilant cat. Like the poets  
that come and go, writing their poems under my shadow,  
we know a thing or two that's purer than love.



## JEHONA E NJË PEME BRENDA SHPIRTIT TË POETIT

Jam një selvi pranë qendrës së Prishtinës,  
bisedoj pa fjalë dhe ndaj kujtime  
me një vargëzues të ri që pushon në hijen time.  
Kokat dhe mendimet tona janë ngritur drejt reve,  
rrenjëjt tona janë ngulitur në shtresat e thella të tokës.

Para disa qindra vitesh, një bujk i vjetër më mbolli  
në buzë të një lumi, pranë një fshati të vogël me pak shtëpi  
prej balte dhe gurësh të shpërndarë,  
që sot janë shndërruar në këtë qytet modern.  
Kam parë luftëra, qytetin të kalojë dorë më dorë  
nën ushtri pushtuese të ndryshme,  
kam mësuar shumë gjuhë, jam familjarizuar  
me lloj-lloj muzike dhe këngësh.  
Kam dëshmuar zjarre të mëdha, shkatërrime  
dhe rindërtimin e shtëpive të reja;  
kam parë breza fëmijësh të luajnë, të shpikin lojëra  
nën hijet e mia, me rrobat e tyre shumëngjyrëshe.

E lejoj poetin t'i shkruajë ndjenjat e tij në fletore;  
e vetmja gjë që mund t'i ofroj janë këto këngë eoliane,  
tingujt gumëzhitës që prodhoj nga dridhjet  
me ndihmën e gjetheve të mia, vetëm kur fryn era.

E ndiej përpara erën që po vjen, e jetoj plotësisht;  
jam i njohur me të gjitha hapat që njerëzit dhe kafshët  
lënë mbi borë në dimër; jam gjithashtu  
njohës i formave të kristaleve të ndryshme të borës.

Ndërsa gjërat e botës nuk lëvizin oxhaqe  
të mbushura me heshtje, dyer e dritare të hapura a të  
mbyllura



jam njohur edhe me shtegtimet e shpendëve,  
për shembull, lejlekët që vijnë nga Afrika në pranverë,  
sjellin pasardhësit e tyre dhe u mësojnë të fluturojnë  
para se të kthehen sërish në shtëpi në fund të vjeshtës.

Duke e ditur mirë stuhinë që po vjen, shpirti im  
është po aq i trazuar sa lumi pranë meje.  
Kam sy të fshehtë, të ngjashëm me sytë e një mace  
vigjilente.  
Si poetët që vijnë e shkojnë, duke shkruar vargjet e tyre  
nën hijen time, ne dimë një a dy gjëra  
që janë më të pastra se vetë dashuria.



## LIKE WATCHING THE SEA CHANGE COLOR

It was a late afternoon. After playing  
a backgammon game with some villagers,  
I followed the footsteps, at times shallow,  
in other instances, deep, someone left  
on the snow. They led me into the doors  
of a dark cave.

Entering a dark tunnel, I unfolded my cape,  
wrapped it around my waist. Moments later  
I, too, became a part of the cold darkness.

Long ago, in the city, when the lights went out  
my hands, following the handrails,  
allowed me to find my way out of the dark.  
Here, taking some steps, I was completely lost.  
Shouting, I could only hear my echo,  
I could no longer knock down midnight's door.

In search of light, the unprepared traveler  
loses time and space only in endless dark caves.

I felt, here I was in a completely new world  
that no longer tolerated a child's heart.  
Only children can invent a way out of the dark.

When objects fall into blackholes they have  
no possible way to return to the real world.  
Either I had to surrender to the dark,  
or invent my way out of the impasse.

Knowing that anything you lose comes round  
in another form, I had known some animals,



like a mole that digs the ground and lives in darkness,  
and when it reaches the surface, it is blinded.  
And some Shamans, after placing their writings  
on the branches of a fig tree, were able to make  
trips into the center of the earth and return.  
And the Whirling Dervishes, through twirling,  
could connect themselves from deep layers  
of the earth to the heavens above in a trance.

Not being a Shaman or a Whirling Dervish,  
leaning down and grabbing a pair of rocks  
I began striking them at each other, creating sparks  
for soon or later to get out of the impasse.

Maybe in a dream, I will find my way back  
as in the dream of a dreamed one,  
the dreamer finally awakes.

Scribbling my thoughts into my soul  
in my scientific mind, soon or later, I'll discover  
a higher-dimensional universe, along whose stratum,  
in between the unknown space-time folds,  
turning into a modern Shaman, inventing new maths,  
whirling my way out of the Uncertainty Principle  
that is at the base of our quantum existence,  
taking with me a few unintelligible characters  
I'll discover, like a tailor, how to cut and paste time  
with an invisible string attached to a needle,  
and make new clothes using Tachyons,  
and like a poet, uncover a universal language  
and take all for rides, in and out of dark caves.



## SI TË SHOHËSH DETIN TË NDRYSHOJË NGJYRË

Ishte vonë pasdite. Pasi luajta  
një lojë tavëlli me disa fshatarë,  
ndoqja gjurmët - herë të cekëta,  
herë të thella - që dikush kishte lënë  
mbi borë. Ato më çuan te dyert  
e një shpelle të errët.

Duke hyrë në një tunel të errët, shpalosa mantelën,  
e lidha rreth belit. Pak çaste më vonë  
edhe unë u bëra pjesë e errësirës së ftohtë.

Dikur, në qytet, kur dritat fikeshin,  
duart e mia, duke ndjekur parmakët,  
më ndihmonin të gjeja rrugën jashtë errësirës.  
Këtu, pasi bëra disa hapa, isha plotësisht i humbur.  
Duke bërë titur, dëgjoja vetëm jehonën time;  
s'mund ta trokisja më derën e mesnatës.

Në kërkim të dritës, udhëtari i papërgatitur  
humb kohën dhe hapësirën vetëm në shpella të pafundme  
errësire.

Ndjeva se isha këtu, në një botë krejtësisht të re,  
që nuk e duronte më zemrën e një fëmije.  
Vetëm fëmijët mund të shpikin një rrugëdalje nga errësira.

Kur objektet bien në vrima të zeza,  
nuk kanë asnjë mundësi të kthehen në botën reale.  
Ose duhej t'i dorëzohesha errësirës,  
ose të shpikja rrugën time për të dalë nga ngërçi.



Duke ditur se çdo gjë që humb kthehet në një formë tjetër,  
dija për disa kafshë, si urithi që gërmon tokën  
dhe jeton në errësirë, e kur del në sipërfaqe verbohet.  
Dhe për disa Shamanë, që pasi vendosnin shkrimet e tyre  
në degët e një fiku, ishin në gjendje të bënin  
udhëtime drejt qendrës së tokës dhe të ktheheshin.  
Dhe Dervishët Rrotullues, që përmes rrotullimit  
lidheshin nga shtresat e thella të tokës  
me qiejt përmbi, në një ekstazë.

Duke mos qenë as Shaman e as Dervish Rrotullues,  
u përkula dhe kapa dy gurë,  
fillova t'i përplas njëri me tjetrin, duke krijuar shkëndija,  
që herët a vonë të dilja nga ngërçi.

Ndoshta në një ëndërr do ta gjej rrugën e kthimit,  
si në ëndrrën e një të ëndërruari,  
kur ëndërrimtari më në fund zgjohet.

Duke gërvishtur mendimet në shpirt,  
me mendjen time shkencore, herët a vonë do të zbuloj  
një univers me dimensione më të larta, përgjatë shtresave të  
të cilit, mes palëve të panjohura të hapësirë-kohës,  
duke u shndërruar në një Shaman modern, duke shpikur  
matematika të reja,  
duke u rrotulluar jashtë Parimit të Pasigurisë  
që është në themel të ekzistencës sonë kuantike,  
duke marrë me vete disa shenja të pakuptueshme,  
do të zbuloj, si një rrobaqepës, si të pres dhe të qep kohën  
me një fill të padukshëm të lidhur në një gjilpërë,  
të krijoj rroba të reja duke përdorur takionë,  
dhe si poet, të zbuloj një gjuhë universale  
e t'i marr të gjithë në udhëtime,  
brenda e jashtë shpellave të errëta.



## ON A BOAT RIDE

Hudson River was flowing into the Atlantic Ocean, beneath Verrazano Bridge's watchful glances. Poetess settled quietly at the rear of a boat under the morning shadows of tall buildings feeling she has no mind, ears, or tongue today was anticipating the source of thought and words will notice her, have her translate her secrets into songs. Migration of lights between her stanzas forever tied to the routes of her heart's pain she had penned at the edges of her poetry books were nudging simultaneously in four directions.

As the sun began to slowly rise, thoughts, finally reaching her lips, began climbing over the waves to chase the hours and the new day's arrival. Dense shadows of Manhattan's tall buildings casting toward Jersey City's shores at early hours, too, were aiding her to hide her feelings from looking back a few times, loading her with new inspirations rising from the sweet waters moving down towards the ocean's salty existence.

Beneath her watchful eyes that reminisce everything that happened between her and her new lover was compelling her to feel as if the twelve spheres of heaven too were drowned at this forsaken place, where the ship of her being was about to sink.

She felt her mind was like an old harp that was left alone in a room in the attic of her frame. She had been waiting for this moment, for the time to arrive, to re-tune, tighten, and temper



## **The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

her emotions and begin writing new love songs.  
On her left hand, she found herself drawing  
the glove that was meant for the right.

She was on a vessel carrying her from Jersey City  
towards the Poets House in lower Manhattan  
where she was invited to read her new poems  
on “Spell of Love’s Pains Rising from the Sea.”



## NË NJË UDHËTIM ME ANIJE

Lumi Hudson derdhej në Oqeanin Atlantik,  
nën vështrimet vigjilente të Urës Verrazzano.  
Poetja ishte vendosur qetësisht në pjesën e pasme të anijes,  
nën hijet e mëngjesit të ndërtesave të larta,  
duke ndier se sot s'kishte as mendje, as veshë, as gjuhë,  
por priste që burimi i mendimit dhe i fjalës  
ta vinte re, t'ia përkthente sekretet  
në këngë. Migrimi i dritave mes strofave të saj,  
i lidhur përgjithmonë me shtigjet e dhimbjes së zemrës,  
që ajo i kishte shkruar në skajet e librave të poezisë,  
shtynte njëkohësisht në katër drejtime.

Teksa dielli nisi të ngrihej ngadalë, mendimet, më në fund,  
duke mbërritur në buzët e saj, filluan të ngjiteshin mbi  
dallgë për të ndjekur orët dhe ardhjen e ditës së re.  
Hijet e dendura të ndërtesave të larta të Manhatanit,  
që binin herët drejt brigjeve të Jersey City-t,  
ndihmonin gjithashtu që ajo t'i fshihte ndjenjat,  
duke mos u kthyer pas disa herë, duke e ngarkuar  
me frymëzime të reja që ngriheshin nga ujërat e ëmbla,  
të cilat rridhnin drejt kripësisë së oqeanit.

Nën sytë e saj vigjilentë, që kujtonin  
gjithçka që kishte ndodhur mes saj  
dhe dashurisë së re, ajo ndihej  
sikur edhe dymbëdhjetë sferat e qiellit  
të ishin mbytur në këtë vend të braktisur,  
ku anija e qenies së saj ishte gati të fundosej.

Ajo ndiente se mendja e saj ishte si një harpë e vjetër  
e lënë vetëm në një dhomë në papafingon e qenies së saj.  
E kishte pritur këtë çast, këtë kohë  
që të mbërrinte, për t'i riakorduar, shtrënguar dhe zbutur



emocionet e saj dhe për të nisur të shkruante këngë të reja dashurie.

Me dorën e majtë, e gjeti veten duke vizatuar dorëzën që ishte menduar për të djathtën.

Ajo ishte në një mjet lundrues që e çonte nga Jersey City drejt Shtëpisë së Poetëve në Manhatanin e Poshtëm, ku ishte ftuar të lexonte poezitë e saj të reja mbi “Magjinë e dhimbjeve të dashurisë që ngrihen nga deti.”



## STRANGE VOYAGES IN SPACETIME

Waters flowing deep into tomorrows  
set out from his fingers, stirring the past.  
Drifting back in time, wearing an age-old  
Cossack uniform and disguised as a tailor,  
he traveled to his great-grandpa's house  
located at the outskirts of the snow-laden  
Elbrus Mountain in the middle of Caucasus.

It was a time long before his grandpa was born.  
Knowing the events that took place during  
the next hundred years, he convinced  
his great-grandpa to follow him to his  
futuristic ship he had arrived in, now  
hidden in a nearby cave, taking him on a flight  
into the house of a philosopher and poet, Li He,  
an official of the Qing dynasty, a native of  
Jinxiang, Shandong, thousands of miles away.

Welcomed by Li He, they ended up spending  
two years at his residence, learning Chinese,  
Chinese calligraphy, studying the great works of Li Po  
and daily consuming a yellow Shaoxing wine  
made from glutinous rice.

One day, taking an excuse to leave for a while,  
he returned to New York in the nineteen sixties.  
He knew he had kidnapped his great-grandpa  
long before he was to marry great-grandma,  
wondered how he himself ended up where he is.  
Making another trip back to Caucasus during  
early twentieth century, he was shocked to see  
Chinese emblems on the old walls of grandpa's house



and the names Li He and Li Po were carved into its walls, some of their poems adorning its confines.

The grandfather paradox is a logical contradiction in time travel theory. A traveler goes back in time and kills their grandfather before their parent is conceived.

This implies the traveler is never born, creating a loop where they cannot exist to travel back, suggesting that backward-time travel is impossible.

He was not a killer, but he had taken his great-grandpa so far away, knowing he will never be able to return home, at least within those days' absolute realities.

He now realized how the old paradox was no longer a puzzle. Time was no longer a straight path when you travel back and forth into the past and the future. You travel in a Garden of Forking Paths.

As you motion, you remain on one geodesic as your life also continually splits into other lanes. You remain forever on one of those paths, but another identical copy of you remains on another a holographic copy now leading into a different realm.

He knew he always lived in a holographic universe that his reality was a projection of information stored on a distant lower-dimensional surface and the total information in a volume of space was encoded in its boundary. He wanted to sit back, prove that the boundary of boundary does not exist.

Possibly Two-Time Physics needed to be re-expressed in new dimensions resembling octonionic numbers



all to be based on newly created holographic principles.

New knowledge in the mind was going to open doors  
to await the night, to bring know-how to what  
the darkness and its hidden shadows were to bring.

Drinking a new cup of wine produced from words  
was making him thirstier as he looked at himself  
from the other side of the convex Chinese mirrors.  
Perhaps the knowledge he was seeking was hidden  
in the saxophone's sobbing in his pure heart and soul.



## UDHËTIME TË ÇUDITSHME NË HAPËSIRË-KOHË

Ujërat që rrjedhin thellë në të nesërmet  
nisën nga gishtat e tij, duke trazuar të shkuarën.  
Duke u kthyer pas në kohë, i veshur me një uniformë të  
lashtë kozake dhe i maskuar si rrobaqepës,  
udhëtoi drejt shtëpisë së stërgjyshit të tij,  
e vendosur në skajet e malit të mbuluar me borë  
Elbrus, në mes të Kaukazit.

Ishte një kohë shumë përpara se të lindte gjyshi i tij.  
Duke i ditur ngjarjet që do të ndodhnin gjatë  
njëqind viteve të ardhshme, e bindi  
stërgjyshin ta ndiqte drejt anijes së tij futuriste  
me të cilën kishte mbërritur, tani  
e fshehur në një shpellë pranë, duke e marrë me vete  
në një fluturim drejt shtëpisë së filozofit dhe poetit Li He,  
një zyrtar i dinastisë Qing, vendas nga  
Jinxiang, Shandong, mijëra milje larg.

I mirëpritur nga Li He, përfunduan duke kaluar  
dy vjet në banesën e tij, duke mësuar  
gjuhën kineze, kaligrafinë kineze, duke studiuar veprat e  
mëdha të Li Po-së  
dhe duke pirë çdo ditë verën e verdhë Shaoxing  
të bërë nga orizi ngjitës.

Një ditë, duke gjetur një justifikim për t'u larguar për pak,  
u kthye në Nju Jork në vitet gjashtëdhjetë.  
E dinte se e kishte "rrembyer" stërgjyshin e tij  
shumë kohë para se ai të martohej me stërgjyshen,  
dhe pyetej si kishte përfunduar vetë aty ku ishte.



Duke bërë një udhëtim tjetër drejt Kaukazit në fillim të shekullit XX, u trondit kur pa emblema kineze në muret e vjetra të shtëpisë së gjyshit, dhe emrat Li He dhe Li Po të gdhendur në mure, me disa nga poezitë e tyre që zbukuronin hapësirën.

Paradoksi i gjyshit është një kundërshti logjike në teorinë e udhëtimit në kohë: një udhëtar kthehet pas në kohë dhe vret gjyshin e tij para se prindi të konceptohet.

Kjo nënkupton se udhëtari nuk lind kurrë, duke krijuar një rreth vicioz ku ai s'mund të ekzistojë për t'u kthyer pas, duke sugjeruar se udhëtimi mbrapsht në kohë është i pamundur.

Ai nuk ishte vrasës, por e kishte marrë stërgjyshin shumë larg, duke e ditur se ai nuk do të mund të kthehej më në shtëpi, të paktën brenda realiteteve absolute të atyre ditëve.

Tani e kuptoi se paradoksi i vjetër nuk ishte më enigmë. Koha nuk ishte më një vijë e drejtë kur udhëton përpara e mbrapa në të shkuarën dhe në të ardhmen. Udhëton në një Kopsht të Shtigjeve që Ndahen.

Ndërsa lëviz, mbetesh në një gjeodezik, por jeta jote vazhdimisht ndahet në korsi të tjera. Ti mbetesh përgjithmonë në një prej atyre shtigjeve, por një kopje tjetër identike e jotja mbetet në një tjetër, një kopje holografike që tashmë hyn në një mbretëri tjetër.



E dinte se gjithmonë kishte jetuar në një univers holografik,  
se realiteti i tij ishte një projekcion informacioni  
i ruajtur në një sipërfaqe të largët me dimension më të ulët,  
dhe se i gjithë informacioni në një vëllim hapësire  
ishte i koduar në kufirin e tij.

Dëshironte të ulej qetë  
dhe të provonte se kufiri i kufirit nuk ekziston.

Ndoshta Fizika e Dy Kohëve duhej të riformulohej  
në dimensione të reja që i ngjajnë numrave oktoneonikë,  
të gjitha të bazuara në parime të reja holografike.

Dija e re në mendje do të hapte dyer  
për të pritur natën, për të sjellë njohuri  
mbi atë që errësira dhe hijet e saj të fshehta do të sillnin.

Duke pirë një gotë të re vere të prodhuar nga fjalët,  
ai bëhej edhe më i etur, teksa shihte veten  
nga ana tjetër e pasqyrave kineze konvekse.  
Ndoshta dija që kërkonte  
ishte e fshehur në vajtimin e saksofonit  
në zemrën dhe shpirtin e tij të pastër.



## OPENING PANDORA'S BOX

Camouflaged behind the walls of his soul,  
in a hurry to keep up with writing,  
the modern-day versifier struck open  
new windows to his obscured life.  
His clever fingers were grasping  
the golden key only the mystics knew  
that can open the doors leading to  
one's destiny during time travel.

Peeping through the panes with the help  
of his third eye outside the light cone,  
whirling dancer and musician,  
drumming and chanting, wandered  
into the new cosmos by generating  
a fresh new path that avoided  
black hole horizons and white dwarfs  
through a nearly empty landscape,  
got ready to discover a double door  
to the hidden spiritual world,  
while his mind kept him busy  
adjusting the direction of time,  
forcing him to remain on the  
main road of this newly created  
Garden of Forking Paths.

He wanted to meet aliens,  
strangers with a dozen eyes  
and eighteen senses, possibly  
trade shadows with them,  
become fully transparent  
only when his obscured words  
would twirl and become visible  
in the absence of light, and



thereby making the darkness shine.

The architect within, too, wished  
to reclaim the age-old visions  
that the Chinese Mirrors  
once had stolen away from him,  
those that had disappeared  
between yesterday and the sea.  
Ageless drifter also wanted to train  
his songs to swim inside the cosmos'  
deep layers, his shadows to be able  
to fish in its undiscovered new horizons,  
and to let go of that cloth  
he had spent a lifetime of weaving.

He began to ski down the slope  
of aged white words emanating  
from his soul toward a new time zone,  
away from unmitigated darkness  
leading to the lightning of the classics.



## HAPJA E KUTISË SË PANDORËS

I kamfluuar pas mureve të shpirtit të tij,  
në ngut për të mos mbetur pas me shkrimin,  
vargëzuesi i kohës moderne hapi me forcë  
dritare të reja në jetën e tij të errësuar.  
Gishtat e tij të mprehtë kapnin  
çelësin e artë që vetëm mistikët e njihnin,  
atë që hap dyert që çojnë  
drejt fatit të njeriut gjatë udhëtimeve në kohë.

Duke vështruar përmes xhamave me ndihmën  
e syrit të tij të tretë, jashtë konit të dritës,  
valltar rrotullues dhe muzikant,  
duke rrahur daulle e duke kënduar,  
endeshte në kozmosin e ri duke krijuar  
një shteg krejt të freskët që shmangte  
horizontet e vrimave të zeza dhe xhuxhët e bardhë,  
përmes një peizazhi pothuajse të zbrazët,  
gati për të zbuluar një derë të dyfishtë  
drejt botës së fshehtë shpirtërore,  
ndërsa mendja e tij mbetej e zënë  
duke rregulluar drejtimin e kohës,  
duke e detyruar të qëndronte  
në rrugën kryesore të këtij  
*Kopshti të Shtigjeve që Ndahen,*  
të sapokrijuar.

Ai dëshironte të takonte alienë,  
të huaj me një duzinë sysh  
dhe tetëmbëdhjetë shqisa,  
ndoshta të shkëmbente me ta hijet,  
të bëhej plotësisht i tejdukshëm  
vetëm atëherë kur fjalët e tij të fshehura  
do të rrotulloheshin e do të bëheshin të dukshme



në mungesë të dritës,  
duke e bërë kështu errësirën të ndriçojë.

Arkitekti brenda tij dëshironte gjithashtu  
të rimerrte vizionet e lashta  
që Pasqyrat Kineze  
dikur ia kishin vjedhur,  
ato që qenë zhdukur  
mes djeshmes dhe detit.  
Endacaku i përjetshëm donte të stërviste  
këngët e tij të notonin në shtresat e thella  
të kozmosit, hijet e tij të mund  
të peshkonin në horizontet e reja të pazbuluara,  
dhe të hiqte dorë nga ajo pëlhurë  
që kishte kaluar një jetë të tërë duke e endur.

Ai nisi të rrëshqiste poshtë shpatit  
të fjalëve të bardha të plakura, që buronin  
nga shpirti i tij drejt një zone të re kohore,  
larg errësirës së pamëshirshme,  
drejt vetëtimës së klasikëve.



## YESTERYEAR'S BLUES

He wanted to return to where he began,  
go back into those half-forgotten eras  
to some memories that went hidden  
between spacetime layers across  
unraveled epochs, into those instances  
when time was still divided into hours,  
and carnations according to their scents.

The long and winding road descending  
into his soul was readying to join his sleep,  
endlessly conversing with each other  
often both had to be silent voluntarily,  
resting along, taking naps as they moved  
arm in arm toward oblivion.

In dreams below the old-baffled roads,  
long ago, silence had lost its voice,  
causing it echo down the time where  
days had forgotten to join the nights  
along unfamiliar, inhibited paths.

With their charming movements  
a private school of fish in a pond of  
poet's soul motioned in harmony,  
silently interrogated the stars  
in unison with his all-seeing eyes,  
filtering the skylight through the holes  
ancient gods have pierced  
on blue sheets above.

Shaking the wet winds, dispersing the clouds  
his soul hanging like a padlock  
with lost keys had arrived



to the gates of heaven, unable to enter.

Poet carving holes in a piece of bamboo.  
gently blowing into it, his soul  
opened through seven eyes,  
generating melodies to replace  
the silence in the air through music.

A heart in tune whose beat gave  
its rhythm to the world, across unraveled eras,  
the poet made signs with his pen and verses.

His margins rose over their brims,  
flooding the texts, filled the air,  
flute's melodies rising above the earth  
traced everything back to the first wind.



## BLUES-i I VITEVE TË SHKUARA

Ai donte të kthehej atje ku kishte nisur,  
të rikthehej në ato epoka gjysmë të harruara,  
te disa kujtime që qenë fshehur  
mes shtresave të hapësirë-kohës,  
nëpër epoka të shthurura,  
në ato çaste kur koha ndahej ende në orë,  
dhe karafilat sipas aromës së tyre.

Rruga e gjatë dhe dredha-dredha që zbriste  
në shpirtin e tij po përgatitej të bashkohej me gjumin,  
duke biseduar pa fund me të;  
shpesh të dy duhej të heshtnin me dëshirë,  
të pushonin së bashku, të flinin pak,  
tekrsa ecnin krah për krah drejt harresës.

Në ëndrra, nën rrugët e vjetra të hutuar,  
dikur heshtja e kishte humbur zërin,  
duke bërë që ajo të jehonte poshtë në kohë,  
ku ditët kishin harruar të bashkoheshin me netët  
nëpër shtigje të panjohura, të përmbajtura.

Me lëvizjet e tyre magjepsëse,  
një shkollë private peshqish në pellgun  
e shpirtit të poetit lëvizte në harmoni,  
u bënte pyetje yjeve në heshtje,  
në njëzë me sytë e tij gjithëshikues,  
duke filtruar dritën e qiellit përmes vrimave  
që perënditë e lashta kishin shpuar  
në çarçafët blu përmbi.

Duke tundur erërat e lagështa, duke shpërndarë retë,  
shpirti i tij, i varur si një dry



me çelësa të humbur, kishte mbërritur  
te portat e qiellit, i paafitë të hynte.

Poeti shponte vrima në një copë bambuje,  
frynte butë në të, dhe shpirti i tij  
hapej përmes shtatë syve,  
duke krijuar melodi për të zëvendësuar  
heshtjen në ajër me muzikë.

Një zemër në harmoni, rrahjet e së cilës  
i jepnin ritëm botës përtej epokave të shthurura,  
poeti shënonte shenja me pendën dhe vargjet e tij.

Anët e fletëve u ngritën mbi kufijtë e tyre,  
tekstet u përmytën, ajri u mbush,  
meloditë e fyellit u ngritën mbi tokë,  
duke e kthyer gjithçka te era e parë.



## UNTITLED

You dig up words from your soul.  
Before reaching and spilling from your lips  
they get plunged into your heart's fire.

Unable to read the ashes,  
you appeal to the memory of fire.

The trace left is only a lingering odor  
of burned moments. Thoughts, too,  
are cleansed in such blazes.

Flame remembers only flames,  
only the fire can restore memories.  
You mine more words, pitch them  
to your heart to keep the fire going.

Sprinkling pepper on your tongue,  
drinking hot-boiling coffee in the morn,  
sticking your hand into heated oil,  
or walking on hot, steaming coals,  
you find none are capable of aid.

Do not be afraid of the inner fires,  
thinking they will turn you into ash.  
Remember the whole universe began  
with the hot big bang from which we emerged.

Sooner or later, you must learn  
how to read the flames. It's only then  
you'll become more complete than ruins.



## PA TITULL

Ti gërmon fjalë nga shpirti yt.  
Para se të arrijnë e të derdhen nga buzët,  
ato zhyten në zjarrin e zemrës sate.

I paaftë t'i lexosh hirin,  
i drejtohesh kujtesës së zjarrit.

Gjurmë mbetet vetëm aroma e zgjatur  
e çasteve të djegura. Edhe mendimet  
pastrohen në flakë të tilla.

Flaka mban mend vetëm flakët;  
vetëm zjarri mund t'i rikthejë kujtimet.  
Ti nxjerr sërish fjalë, i hedh  
në zemrën tënde për ta mbajtur zjarrin gjallë.

Duke hedhur piper mbi gjuhë,  
duke pirë kafe përvëluese në mëngjes,  
duke futur dorën në vaj të nxehtë,  
ose duke ecur mbi thëngjij të zjarrtë që nxjerrin avull,  
e kupton se asgjë prej tyre nuk ndihmon.

Mos u frikëso nga zjarret e brendshme,  
duke menduar se do të të kthejnë në hi.  
Kujto se i gjithë universi nisi  
me Shpërthimin e Madh të nxehtë, prej të cilit dolëm.

Herët a vonë duhet të mësos  
si t'i lexosh flakët. Vetëm atëherë  
do të bëhesh më i plotë se rrënojat.



## BECOMING MORE COMPLETE THAN RUINS

You dig up words from your soul.  
Before reaching and spilling from your lips  
they get plunged into your heart's fire.

Unable to read the ashes,  
you appeal to the memory of fire.

The trace left is only a lingering odor  
of burned moments. Thoughts, too,  
are cleansed in such blazes.

Flame remembers only flames,  
only the fire can restore memories.  
You mine more words, pitch them  
to your heart to keep the fire going.

Sprinkling pepper on your tongue,  
drinking hot-boiling coffee in the morn,  
sticking your hand into heated oil,  
or walking on hot, steaming coals,  
you find none are capable of aid.

Do not be afraid of the inner fires,  
thinking they will turn you into ash.  
Remember, the whole universe began  
with the hot Big Bang from which we emerged.

Don't be like the crofter who made his  
own weather and forgot the gust.  
Wind is needed to get the fire going  
and be grateful to the gale in the poet's heart.

And, sooner or later, you must learn  
how to read the flames. It's only then  
you'll become more complete than ruins.



## TË BËHESH MË I PLOTË SE RRËNOJAT

Ti gërmon fjalë nga shpirti yt.  
Para se të arrijnë e të derdhen nga buzët,  
ato zhyten në zjarrin e zemrës sate.

I paaftë t'i lexosh hirin,  
i drejtohesh kujtesës së zjarrit.

Gjurmë mbetet vetëm aroma e zgjatur  
e çasteve të djegura. Edhe mendimet,  
pastrohen në flakë të tilla.

Flaka mban mend vetëm flakët;  
vetëm zjarri mund t'i rikthejë kujtimet.  
Ti nxjerr sërish fjalë, i hedh  
në zemrën tënde për ta mbajtur zjarrin gjallë.

Duke hedhur piper mbi gjuhë,  
duke pirë kafe përvëluese në mëngjes,  
duke futur dorën në vaj të nxehtë,  
ose duke ecur mbi thëngjij të zjarrtë që nxjerrin avull,  
e kupton se asnjëra nuk është e aftë të ndihmojë.

Mos u frikëso nga zjarret e brendshme,  
duke menduar se do të të kthejnë në hi.  
Kujto se i gjithë universi nisi  
me Shpërthimin e Madh të nxehtë, prej të cilit dolëm.

Mos u bëj si bujku i vetmuar që krijoi  
motin e vet dhe harroi vrullin e erës.  
Era është e nevojshme për ta ndezur zjarrin;  
ji mirënjohës për furtunën në zemrën e poetit.

Dhe, herët a vonë, duhet të mësos  
si t'i lexosh flakët. Vetëm atëherë  
do të bëhesh më i plotë se rrënojat.



## UNTITLED

He had woven a spiderweb  
under the bushes to trap words.

Suspended on silken strands,  
swaying like a pendulum  
learned to plot the stars,  
restructured his galaxy  
ushered numerous trips  
into the unknown depths  
of the hidden universe.

Falling in and out of  
blackholes and white dwarfs,  
learned how night tells its tale,  
became familiarized with  
dark legends surrounding it.

Unable to chain light,  
bringing it to a stop  
on the way to imprison  
all his memories,  
gave up his quest for words.

Realizing, in the process of writing,  
words might lose interest  
in the written, akin to himself,  
a traveler, charmed by the road,  
who overlooked his destination.

Distilling images from his dreams  
he abandoned his search  
on a day when the sun was low,  
while his shadow became a giant,  
alleged, soon all will be shadow.



## PA TITULL

Ai kishte thurur një rretë merimange  
nën shkurre për të zënë fjalët.

I varur në fije mëndafshi,  
duke u lëkundur si një lavjerrës,  
mësoi të skicojë yjet,  
ristrukturoi galaktikën e tij,  
oriento i shumë udhëtime  
drejt thellësive të panjohura  
të universit të fshehur.

Duke rënë brenda e jashtë  
vrimave të zeza dhe xhuxhëve të bardhë,  
mësoi se si nata e rrëfen tregimin e saj,  
u njoh me  
legjendat e errëta që e rrethojnë.

I paaftë ta lidhte dritën,  
ta ndalte atë  
në rrugën për të burgosur  
të gjitha kujtimet e tij,  
hoqi dorë nga kërkimi për fjalë.

Duke kuptuar, gjatë procesit të shkrimit,  
se fjalët mund ta humbnin interesin  
për të shkruarën, njësoj si ai vetë,  
një udhëtar i magjepsur nga rruga,  
që kishte anashkaluar destinacionin.

Duke distiluar imazhe nga ëndrrat e tij,  
ai e braktisi kërkimin  
në një ditë kur dielli ishte ulët,  
ndërsa hija e tij u bë gjigante,  
duke pohuar se së shpejti gjithçka do të jetë hije.



## PERFORMANCE

My fictional life  
dressed in tissue,  
hunts sorrows,  
unending dreams  
on a stage of a shadow theatre,  
absorbing all the floodlights,  
and as the brightness ends  
cries coincide with wine glasses.  
You're the puppeteer  
I, your puppet.



## PERFORMANCË

Jeta ime fiktive,  
e veshur me letër të hollë,  
gjuan trishtime,  
ëndrra të pafundme  
në një skenë teatri hijesh,  
duke thithur të gjitha dritat e projektorëve;  
dhe kur ndriçimi shuhet,  
të qarat përputhen me gotat e verës.  
Ti je kukullari,  
unë kukulla jote.



## THE TWO IN ONE

I am split into two halves  
not resembling one another  
as in the two faces of  
an image in a mirror.

Parity is not conserved  
neither in the body,  
nor in the soul.

According to impulse,  
endowed with happiness,  
filled with poetic dreams,  
one side slopes naturally.

The other one is clumsy,  
like the infirm who suffer  
and never heals. Like a drop  
of mercury in the palm of a hand  
he wobbles, sick and ecstatic,  
lost in the layers of spacetime  
all at the same moment.

Yet they always travel together,  
setting out from the mirrors  
returning just to name  
the happiness and the sorrows  
of the universe's rock-filled roads.

When getting together  
at some unknown stopovers  
they settle to play chess,  
exchange glances,  
become like a huge tree



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

that quiets the wind coming  
from seven directions  
in its flower garden and shade  
desolated by reveries.

In such instances, they become  
a branch and thought  
that gives fruits, provides  
shelter and shade.



## DY NË NJË

Jam i ndarë në dy gjysma  
që nuk i ngjajnë njëra-tjetrës,  
si dy fytyrat e  
një imazhi në pasqyrë.

Simetria nuk ruhet,  
as në trup,  
as në shpirt.

Sipas impulsit,  
e dhuruar me lumturi,  
e mbushur me ëndrra poetike,  
njëra anë anohet natyrshëm.

Tjetra është e ngathët,  
si i sëmuri që vuan  
dhe kurrë nuk shërohet. Si një pikë  
zhive në pëllëmbë,  
lëkundet, i sëmurë dhe në ekstazë,  
i humbur në shtresat e hapësirë-kohës  
në të njëjtin çast.

Megjithatë ata udhëtojnë gjithmonë bashkë,  
duke u nisur nga pasqyrat,  
duke u kthyer vetëm për të emërtuar  
lumturitë dhe pikëllimet  
e rrugëve me gurë të universit.

Kur takohen  
në ndalesa të panjohura,  
ulen të luajnë shah,  
shkëmbejnë vështrime,  
bëhen si një pemë e madhe



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

që qetëson erën që vjen  
nga shtatë drejtime  
në kopshtin e saj me lule dhe hijen  
e shkretuar nga përhumbrjet.

Në çaste të tilla, ata bëhen  
degë dhe mendim  
që jep fryte,  
që ofron strehë dhe hije.



## AT THE SHORE

She was lying on a portable lounge chair to my left,  
staring at the sea, listening to the delightful sounds  
the waves make as they reach the shore,  
as pleasing to her heart as Beethoven's Moonlight Sonata.

It seemed as if pale moon's delicate light mixed into the  
foams was ironing out all the chaos settled in her soul,  
while the philosophy of those oscillating white wings  
were vibrating with the shy, trembling shoulders  
of the Caribbean night. I didn't want to know  
what was running through her mind, knew better,  
just let the sea and the earth hear it all in her silence.

Bit drowsy, cigar lit, stretched out on a parallel bench,  
I was quietly wondering, my soul, moving along  
an empty road, and reaching a split,  
if there were only two paths to choose from,  
poetry and science, what would I do?  
I knew I would surely choose the third one.

Her reflection in the waves, like a wet light  
slowly dripped over my tired eyes,  
shined through its open windows, while I wrote my life  
with a twig at hand on empty sands, lounging at my feet.  
A light wind was busy erasing all that I wrote.

I never had the talent or the strength to tell  
the scattered immigrant clouds above  
all my simple sorrows in a night full of  
empty caravans passing through my soul,  
coming from nowhere, going to nowhere.

I rubbed the almost empty wine cup on my forehead,



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

stared at my tired feet, lit up another cigar  
and shot close my eyelids under the humming  
of the waves, softly allowed my absence move into hers,  
as one soul gently moves into another.



## NË BREG

Ajo ishte shtrirë në një karrige të lëvizshme plazhi në të majtën time, duke vështruar detin, duke dëgjuar tingujt e këndshëm që valët nxjerrin kur prekin bregun, po aq të ëmbël për zemrën e saj sa *Sonata e Dritës së Hënës* e Beethovenit.

Duke sikur drita e brishtë e hënës së zbehtë, e përzier me shkumën, po e hekuroste gjithë kaosin e vendosur në shpirtin e saj, ndërsa filozofia e atyre krahëve të bardhë që lëkundën dridhej bashkë me supet e turpshme, që rrëqetheshin të natës karaibiane. Nuk doja ta dija çfarë i kalonte në mendje, e dija më mirë: le ta dëgjonin deti dhe toka gjithçka në heshtjen e saj.

Pak i përgjumur, me cigarën ndezur, i shtrirë në një stol paralel, mendoja qetë; shpirti im, duke ecur përgjatë një rruge të zbrazët e duke mbërritur në një kryqëzim, nëse do të kishte vetëm dy shtigje për të zgjedhur, poezia dhe shkenca, çfarë do të bëja? E dija se me siguri do të zgjidhja të tretën.

Pasqyrimi i saj në valë, si një dritë e lagur, pikonte ngadalë mbi sytë e mi të lodhur, ndriçonte përmes dritareve të hapura, ndërsa unë shkruaja jetën time me një degëz në dorë mbi rërën e zbrazët, shtrirë te këmbët e mia. Një erë e lehtë ishte e zënë duke fshirë gjithçka që shkruaja.

Kurrë nuk pata as talentin e as forcën t'u rrëfej reve shtegtare të shpërndara lart të gjitha hidhërimet e mia të thjeshta, në një natë plot karvane të zbrazëta që kalonin përmes shpirtit tim, duke ardhur nga askundi, duke shkuar drejt askundit.



## The outpost of the time - *Posta e kohës*

---

E fërkova kupën pothuajse bosh të verës në ballë,  
vështrova këmbët e mia të lodhura, ndeza një cigare tjetër  
dhe mbylla fort qepallat nën gumëzhimën  
e valëve; butë lejova mungesën time të zhvendosej në të  
sajën, ashtu si një shpirt zhvendoset me butësi në një tjetër.



## RECOLLECTIONS

To a child, all cities are indistinguishable.  
He acquires wings as he drops from heights.

I was just an innocent young lad,  
she was about ten years older than me,  
when the harbor of the unknown opened up,  
words flew out of me, futile fantasies.  
Recognizing her shadow on the ground,  
unable to lift my eyes off, I floated in silence,  
shook like a boat in the wind, filling the sails.

Her apparition raised a flight of fresh cries  
of early birds of dawn as I crossed  
the furious waters of time in my notebooks,  
supersymmetric fantasies concocted by pen.

One day, placing her arms around me,  
enticing me to her place, taught me to love,  
instructed me on how to please a woman.

I wrote simple poems to amuse her,  
and her young breasts listened to me  
as children sitting around a campfire  
listening to a charming tale.

Years flew by. To this day I still have not forgotten  
how cypresses nearby shook with birds,  
wind with the smell of acacias swelled its wings,  
how a raven drifted across cold space,  
and silence froze, but not those memories.



## KUJTIME

Për një fëmijë, të gjitha qytetet janë të padallueshme.  
Ai fiton krahë teksa bie nga lartësitë.

Unë isha vetëm një djalosh i pafajshëm,  
ajo ishte rreth dhjetë vjet më e madhe se unë,  
kur u hap porti i së panjohurës,  
fjalët më fluturuan, fantazi të kota.  
Duke njohur hijen e saj mbi tokë,  
i paaftë t'i hiqja sytë, notoja në heshtje,  
dridhësia si një varkë në erë, duke mbushur velat.

Shfaqja e saj ngriti një fluturim britmesh të freskëta  
të zogjve të agimit, teksa përshkoja  
ujërat e furishme të kohës në fletoret e mia,  
fantazi supersimetrike të sajua nga pena.

Një ditë, duke më hedhur krahët rreth meje,  
duke më joshur drejt vendit të saj, më mësoi të dashuroj,  
më udhëzoi se si të kënaq një grua.

Shkruaja poezi të thjeshta për ta zbavitur,  
dhe gjoksi i saj i ri më dëgjonte  
si fëmijët ulur rreth një zjarri kampi  
duke dëgjuar një tregim magjepsës.

Vitet fluturuan. Edhe sot e kësaj dite nuk kam harruar  
si selvitë aty pranë dridheshin nga zogjtë,  
si era me aromë akaciesh i frynte krahët,  
si një korb rrëshqiti nëpër hapësirën e ftohtë,  
dhe si heshtja u ngrinë, por jo ato kujtime.



## COLORING VERSES

Barefoot, walking along the shore  
using a dry twig he plucked from the bushes  
began scribbling his future on empty sands  
then he watched a light wind arrive  
with help of rising waves, erasing it all.

When the night arrived, empty caravans,  
coming from nowhere, going to nowhere,  
passed through his soul's empty sands  
leaving no footprints or shadows behind.

Slowly, he began walking in the direction  
of the lighthouse situated at the end of the island.  
A handful of shadows walked past him  
in opposite directions, some being visible  
in the light of the hotels lined along the shore,  
speaking in foreign tongues, he was unaware.

Thinking of the room he had earlier abandoned  
where similar traces remained for a time,  
and how he had taken a few steps to the balcony  
to watch the sea changing color quietly, sitting  
in the silence between one page and the next.

In that lonely afternoon, like the posters on a wall  
he wanted to give colors to his verses,  
unable to decide what shades they should be.

Suspended and at times intersecting  
in the balance of their design, unbroken and  
overlapping like settled and disputed lands  
drawn upon the world maps, flapping like flags



## **The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

in the mind's ever-blown winds, his verses had begun turning into lines and contours, fabric and form.

He felt like a chef who makes a rainbow soup using onion, garlic, tomatoes, carrots, kane, beans and potatoes for texture. He realized in his writings he had left out the seasonings like turmeric, paprica and fresh herbs like parsley and basil. He began rushing back to his room to enhance the flavor and color of his verses left dangling on its walls.



## NGJYRËSIMI I VARGJEVE

Zbathur, duke ecur përgjatë bregut,  
me një degëz të thatë që e këputi nga shkurret,  
filloi të shkarraviste të ardhmen e tij mbi rërën e zbrazët;  
pastaj pa teksa mbërriti një erë e lehtë  
që, me ndihmën e valëve në ngritje, e fshiu gjithçka.

Kur ra nata, karvane të zbrazëta,  
që vinin nga askundi e shkonin drejt askundit,  
kaluan përmes rërave të zbrazëta të shpirtit të tij,  
pa lënë pas as gjurmë e as hije.

Ngadalë, nisi të ecë drejt  
fenerit të vendosur në skajin e ishullit.  
Një grusht hijesh i kaluan pranë  
në drejtime të kundërta, disa të dukshme  
në dritën e hoteleve përgjatë bregut,  
duke folur në gjuhë të huaja, që ai nuk i njihte.

Duke menduar për dhomën që kishte lënë më herët,  
ku gjurmë të ngjashme mbetën për ca kohë,  
dhe si kishte hedhur disa hapa drejt ballkonit  
për të parë detin që ndryshonte ngjyrë në heshtje, ulur  
në qetësinë mes një faqeje dhe tjetrës.

Në atë pasdite të vetmuar, si posterët në një mur,  
ai donte t'u jepte ngjyra vargjeve të tij,  
i paafte të vendoste se çfarë nuancash duhej të kishin.

Të varura dhe herë pas here të ndërthurura  
në ekuilibrin e dizajnit të tyre, të pandërprera dhe  
të mbivendosura si toka të pajtuara e të kontestuara  
të vizatuara në hartat e botës, që valëviten si flamuj



në erërat e përhershme të mendjes, vargjet e tij kishin nisur të shndërroheshin në vija e konture, pëlhurë dhe formë.

Ai u ndje si një kuzhinier që gatuan një supë ylberi me qepë, hudhër, domate, karrota, kallam sheqeri, fasule dhe patate për teksturë. Kuptoi se në shkrimet e tij kishte lënë jashtë erëzat si shafrani i Indisë, paprika, dhe barishtet e freskëta si majdanozi e borziloku. Filloi të nxitojë drejt dhomës së tij për të përmirësuar shijen dhe ngjyrën e vargjeve të tij, të mbetura varur në muret e saj.



## EXILE OF WORDS

In the dark hours of your authenticity  
senses drop into the subconscious,  
to habitations where life is permeated  
under the layers of deep memories  
lain over each other. At such sites  
sentiments and emotions endure  
unexpected transformations.

As you descend into those deposits  
denser and denser patterns turn into  
timeless folklore carried down by the  
history's wind, as in a winter's tale.  
All moments and histories,  
lost universes, revived new ones  
everything, including love  
gets stolen by a little wind  
trembling at your doors in silence.  
Being carried there is not just enough.

You come across locations where some  
words and sentences you once uttered  
were still growing in time's silence,  
in those interludes where time had stopped,  
where love was like a play with short acts  
and long intermissions -and you did not  
succeed in apprehending how to behave  
during those intermissions.  
Unbarred passages lead to dark shafts  
behind the hidden truth barriers.

The deepest feelings you encountered  
long ago in your soul have risen like a tree  
extending away. That wind had stripped you



**The outpost of the time - *Posta e kohës***

---

leaf by leaf of your last bit of green. Perhaps  
loving was short, yet forgetting, so long.

Drinking a mug of words only makes you  
thirstier, and the past can make you anxious.  
Pen and paper at hand, that is how poetry,  
the exile of words begins, reawakening the soul  
beneath a radiance leased from the stars.



## EKZILI I FJALËVE

Në orët e errëta të autenticitetit tënd  
shqisat bien në nëndije,  
në banesa ku jeta përshkohet  
nën shtresat e kujtimeve të thella  
të vendosura njëra mbi tjetrën.  
Në vende të tilla  
ndjenjat dhe emocionet pësojnë  
shndërrime të papritura.

Teksa zbret në ato depozitime,  
modele gjithnjë e më të dendura  
kthehen në folklor të përjetshëm,  
të bartur nga era e historisë,  
si në një përrallë dimri.  
Të gjitha çastet dhe historitë,  
universet e humbura, të rilindurat e reja,  
gjithçka, përfshirë dashurinë,  
vidhet nga një erë e vogël  
që dridhet në heshtje para dyerve të tua.  
Të bartesh atje nuk mjafton.

Has vende ku disa  
fjalë dhe fjali që dikur i shqiptove  
ende rriteshin në heshtjen e kohës,  
në ato ndërkohëza kur koha ndalonte,  
ku dashuria ishte si një shfaqje  
me akte të shkurtra  
dhe ndërprerje të gjata  
dhe ti nuk arrite të kuptoje  
si duhej të sillleshe  
gjatë atyre ndërprerjeve.  
Kalime të hapura çojnë drejt boshteve të errëta  
pas pengesave të së vërtetës së fshehur.



Ndjenjat më të thella që dikur  
i takove në shpirtin tënd  
janë ngritur si një pemë  
që shtrihet larg.  
Ajo erë të kishte zhveshur  
gjethe pas gjetheje  
nga gjelbërimi yt i fundit.  
Ndoshta dashuria ishte e shkurtër,  
por harresa kaq e gjatë.

Të pish një filxhan fjalësh  
vetëm sa të shton etjen,  
dhe e kaluara mund të të trazojë.  
Me lapsin dhe letrën në dorë,  
kështu nis poezia  
mërgimi i fjalëve,  
duke rizgjuar shpirtin  
nën një dritë të marrë hua nga yjet.



## AND LET IT BE . . .

Old blooms dropped like falling tears  
into my soul. Shapeless memories, too,  
have a way of sinking to the sea's depths.

On a bus ride, going to the university,  
it feels as if all five of my senses are linked  
to another individual. I will soon be lecturing  
on the purpose of scientific inquiry, that of  
continuously discovering conservation laws,  
linking them to one another for scientific  
progress. Every word I will utter will be  
the echo of lost words. It is not the weakness  
of the soul. In the process of writing, words  
lose interest in the written, like some travelers  
in this bus, charmed by the road, momentarily  
have lost their destination, like me.

Quickly, I stare at my notes. Formidable black holes  
swallow all the information the timeless light carries  
in multiple directions ever since the Big Bang,  
or time immemorial. I will not lecture on  
why the metal rose never withers, yet it has  
no fragrance. It's gone, the metal rose.  
And let it be. . .

When you have a split existence between science  
and the poetics of space-time, you are forced  
to lose some of your thoughts.  
And let it be. . .

I plan not to grieve, knowing that anything you lose  
will come around in another form.  
And let it be. . .



## DHE LE TË JETË...

Lule të vjetra ranë si lot që bien  
në shpirtin tim. Edhe kujtimet pa formë  
kanë mënyrën e tyre të fundosen  
në thellësitë e detit.

Në një udhëtim me autobus drejt universitetit,  
më duket sikur të pesë shqisat e mia  
janë të lidhura me një qenie tjetër.  
Së shpejti do të ligjëroj  
mbi qëllimin e kërkimit shkencor  
zbulimin e pandërprerë të ligjeve të ruajtjes,  
duke i lidhur ato me njëra-tjetrën  
për përparimin e shkencës.  
Çdo fjalë që do të shqiptoj  
do të jetë jehona e fjalëve të humbura.  
Nuk është dobësi e shpirtit.  
Në procesin e shkrimit, fjalët  
humbin interes për të shkruarën,  
si disa udhëtarë në këtë autobus  
që, të magjepsur nga rruga,  
për një çast kanë humbur destinacionin,  
si unë.

Shpejt shikoj shënimet e mia.  
Vrimat e zeza të frikshme  
gëlltisnin gjithë informacionin  
që drita e përjetshme bart  
në drejtime të shumta  
që nga Shpërthimi i Madh,  
apo që nga koha e pakohë.  
Nuk do të ligjëroj  
pse trëndafili prej metali nuk vyshket kurrë,  
por nuk ka aromë.



Ai është zhdukur, trëndafili metalik.  
Dhe le të jetë...

Kur ke një ekzistencë të ndarë  
mes shkencës  
dhe poetikës së hapësirë-kohës,  
detyrohesh të humbësh  
disa nga mendimet e tua.  
Dhe le të jetë...

Vendos të mos pikëllohem,  
duke ditur se gjithçka që humbet  
kthehet përsëri në një formë tjetër.  
Dhe le të jetë...



## IRON SPRINGS

*-Written in Hotel du Quai Voltaire, Paris 2025*

Fifteen springs at the bottom  
of a dreaming, empty divan  
start a gossip in a black night.

Lying over it, a night owl,  
I am listening to their roars,  
tearing the night apart,  
staying as a guest at an  
ancient Parisian hotel room  
from where Baudelaire wrote  
to his friend Theophile Gautier  
that being a supernaturalist,  
he could not find the needed forms  
in nature, but the most remarkable  
ones are revealed to him  
through the chattering springs  
at the bottom of one's couch.

Springs, like the metallic roses  
do not have fragrance, yet  
they are filled with memories  
as museums of past centuries  
with authentic galleries.

Occasionally stepping out of  
the dark mists, those divans  
are part of the echoing houses  
preserving dark legends and  
